

Qasja në Dokumentet Publike Mbrojtja e Burimeve të Gazetarëve dhe Sinjalizimi

Maj, 2016

Doracak i Rasteve Kryesore të Gjykatës
Europiane për të Drejtat e Njeriut

I përdorshëm për gazetarë dhe të interesuarit tjerë në
lidhje me fushën e lirisë së shprehjes



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar
nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë.

Implementuar nga
**Thomson
Foundation**

Qasja në Dokumentet Publike Mbrojtja e Burimeve të Gazetarëve dhe Sinjalizimi

Maj, 2016

**Doracak i Rasteve Kryesore të Gjykatës
Europiane për të Drejtat e Njeriut**

I përdorshëm për gazetarë dhe të interesuarit tjerë në
lidhje me fushën e lirisë së shprehjes



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar
nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë.

Implementuar nga
**Thomson
Foundation**

Përgatiti:

Flutura Kusari

flutura@article10.org

Kontribuoi me sugjerime:

Florent Spahija

Maj 2016

Botuar nga Fondacioni Thomson

Fondacioni Thomson

46 Chancery Lane

London WC2A 1JE T.

+44 (0)20 3440 2440

thomsonfoundation.org

Twitter: @thomfound

Ky publikim është bërë me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e Fondacionit Thomson dhe nuk paraqet qëndrimet e Bashkimit Europian.



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë.

Implementuar nga
**Thomson
Foundation** 

1. Hyrje	6
1.1 Disa shpjegime bazike rreth organizimit të Gjykatës dhe procedurës para saj	10
2. E drejta e qasjes në dokumente dhe informacione publike	12
2.1 Khurshid Mustafa dhe Tarzibachi kundër Suedisë	14
2.2 Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë	15
2.3 Kenedi kundër Hungarisë	17
2.4 Gillberg kundër Suedisë	18
2.5 Youth Initiative for Human Rights kundër Serbisë	20
2.6 Österreichische Vereinigung kundër Austrisë	21
2.7 Rosiiianu kundër Rumanisë	23
2.8 Guseva kundër Bullgarisë	24
3. E drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetarëve	26
3.1 Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar	28
3.2 Roemen dhe Schmit kundër Luksemburg	29
3.3 Ernst dhe të tjerët kundër Belgjikës	31
3.4 Voskuil kundër Holandës	33
3.5 Tillack kundër Belgjikës	35
3.6 Financial Times dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar	37
3.7 Sanoma Uitgevers kundër Holandës	39
3.8 Ressiot dhe të tjerët kundër Francës	41
3.9 Martin dhe të tjerët kundër Francës	43
3.10 Telegraaf Media Nederland Landelijke Media B.V. dhe të tjerët kundër Holandës	45
3.11 Saint-Paul Luxembourg kundër Luksemburgut	47
3.12 Nagla kundër Letonisë	49
4. Sinjalizimi	52
4.1 Guja kundër Moldavisë	54
4.2 Marchenko kundër Ukrainës	57
4.3 Kudeshkina kundër Ruisë	58
4.4 Heinisch kundër Gjermanisë	60
4.5 Bucur and Toma kundër Rumanisë	62
4.6 Matúz kundër Hungarisë	64
4.7 Görmüş dhe të tjerët kundër Turqisë	66
5. Burimet	70

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 8

E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

- Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.
- Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

Neni 10

Liria e Shprehjes

- Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv, ose kinematografik të pajisen me licencë.
- Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve, ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale, ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.



Seanca solemne e GjEDNj-së me rastin e fillimit të vitit gjyqësor 2013
Ish-presidenti i Gjykatës, Dean Spielmann
Foto: David Betzinger, © Këshilli i Europës



Ndërtesa e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut
Foto: Ellen Wuibaux, © Council of Europe

1. Hyrje



1. Hyrje

Respektimi dhe garantimi i të drejtave të njeriut në përputhje me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) dhe standardet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) është parakusht në integrimin europian të Kosovës dhe demokratizimin domethënës të saj. Bazuar në nenin 22 dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës, Konventa zbatohet drejtpërdrejt në Kosovë, ka prioritet në rast konflikti me dispozitat ligjore vendore dhe gjykatat vendore janë të obliguara që rastet e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore t'i interpretojnë në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNJ-së.

Testi prej tre hapash i GjEDNJ-së:

- i) a ka pasur ndërhyrje në të drejtën e garantuar me Konventë dhe a është ndërhyrja e parashikuar me ligj?
- ii) a e ndjek apo synon ndërhyrja një qëllim legjitim?
- iii) a është ndërhyrja e nevojshme në një shoqëri demokratike?

Në vendet demokratike, e drejta e lirisë së shprehjes konsiderohet si një ndër të drejtat themelore të njeriut. Edhe në Kosovë kjo e drejtë është kategori kushtetuese dhe garantohet me ligje specifike. Ekzistimi i legjislacionit vendor ua mundëson qytetarëve në përgjithësi, dhe gazetarëve në veçanti, të realizojnë të drejtën e tyre për liri të shprehjes përmes rrugëve ligjore. Në raste të tilla, gjyqësori dhe institucionet tjera duhet të zbatojnë precedentët e GjEDNJ. Zbatimi i praktikave më të mira në fushën e të drejtës së lirisë së shprehjes të krijuara nga GjEDNJ-ja dëshmon nivelin e zbatueshmërisë së Kushtetutës dhe gatishmërisë së Kosovës që të bëhet anëtare e Bashkimit Europian.

Rastet më të shpeshta gjyqësore në Kosovë nga sfera e lirisë së shprehjes zakonisht kanë të bëjnë me shpifjen. Mirëpo nga viti 2014 institucionet publike, gjyqësore dhe ekzekutive janë ballafaquar edhe me raste të kërkesave për qasje në informacione dhe dokumente publike, raste nga e drejta e gazetarëve që të mbrojnë burimet e tyre dhe raste të sinjalizimit. Këto përbëjnë kategori të reja të së drejtës për t'u shprehur, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Gjykatën e Strasburgut, e cila deri më tani ka zhvilluar një numër të kufizuar të precedentëve në këto fusha. Duke marrë parasysh këto zhvillime, ky doracak ofron një përmbledhje të rasteve kryesore të GjEDNJ-së në fushën e të drejtës për qasje në dokumente publike, të drejtës së mbrojtjes së burimeve të gazetarëve dhe mbrojtjes së sinjalizuesve, me qëllim që të jetë e përdorshme për gazetarët e Kosovës dhe gjithë të interesurit tjerë në lidhje me fushën e lirisë së shprehjes.

Përmbledhja prej 27 rastesh synon të ndihmojë profesionistët e mediave, gjykatësit, prokurorët, policët dhe avokatët që të familjarizohen me standardet më të reja të GjEDNJ-së në fushat e lartpërmendura. Ato përfshijnë raste siç janë përdorimi i antenës satelitore nga një çift emigrantësh për të përcjellur lajme në gjuhën amtare, përgjimi i gazetarëve nga shërbimi i inteligjencës, qasja e një shkenctari në dokumentet e arkivuara të inteligjencës, kërkesat e kompanive të fuqishme për të zbuluar burimin që u ka rrjedhur informacionin të gabuar gazetarëve, kërkesën e një pale për t'i lëshuar sasi të madhe të dokumenteve publike, nxjerrjen e shënimeve tatimore, konfiskimin e dokumenteve të rrjedhura te gazetarët nga ana e hetuesve dhe deri te konfiskimi i fotografive të një reviste që po mbulonte një garë ilegale veturash me zotimin se do t'i bënte fytyrat e protagonistëve të paidentifikueshme kur të dilnin në shtyp.



Rastet që kanë të bëjnë me të drejtën e lirisë së shprehjes, GjEDNj-ja i gjykon bazuar në testin e njohur prej tre hapash duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve:

- i) a ka pasur ndërhyrje në të drejtën e garantuar me Konventë dhe a është ndërhyrja e parashikuar me ligj?
- ii) a e ndjek apo synon ndërhyrja një qëllim legjitim?
- iii) a është ndërhyrja e nevojshme në një shoqëri demokratike?

Ndërhyrje mund të konsiderohet çdo kufizim, sanksion, ose procedurë si për shembull obligimi për të kërkuar leje për të ushtruar një të drejtë. Ndërhyrja e bërë nga autoritetet duhet të jetë e parashikuar me legjislacion kryesor ose sekondar. Legjislacioni duhet të jetë cilësor dhe në harmoni me parimin e sundimit të ligjit. Shteti duhet të ketë arsyetim legjitim për ndërhyrjen e bërë që mund të jetë në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial, sigurisë publike, mbrojtjes së dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve, ndalimit të publikimit të informatave konfidenciale ose garantimit të paanshmërisë së pushtetit gjyqësor. Gjatë shqyrtimit të pyetjes nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, Gjykata vlerëson nëse eziston një nevojë shoqërore urgjente për ta bërë atë ndërhyrje dhe nëse ndërhyrja është proporcionale me qëllimin e ndjekur. Rastet e shpjeguara në këtë përmbledhje reflektojnë arsyetimin e GjEDNj-së bazuar në këtë test.

Rastet janë përmbledhur nga aktgjykimet origjinale të Gjykatës, në mënyrë objektive, pa interpretime apo opinione të autores. Përmbledhja përfshin rastet e gjykuara deri në maj 2016 dhe përdoruesit e saj inkurajohen që të ndjekin zhvillimet e mëtutjeshme dhe të përdorin gjatë punës së tyre rastet më të reja.

Meqenëse aktgjykimet shpeshherë trajtojnë më shumë se një të drejtë të garantuar me Konventë, doracaku kufizohet vetëm te pjesët që trajtojnë të drejtën e lirisë së shprehjes që zakonisht janë nenet 8 dhe 10. Përmbledhja ka tre kapituj, ndërsa renditja e rasteve në kapitujt përkatës është bërë duke u nisur nga rastet e para që janë gjykuar dhe duke përfunduar me rastet më të reja. Për të lehtësuar identifikimin e rasteve, numri i kërkesës dhe data e plotfuqishmërisë figuron në secilin rast të përmendur. Duhet të nënvizohet se Kosova është një ndër katër shtetet e vetme krahas Bjellorusisë, Kazakistanit dhe Vatikanit që shtrihen plotësisht ose pjesërisht në kontinent, por që nuk janë ende anëtare të Këshillit të Europës (KE), gjë që nënkupton që kosovarët nuk kanë ende të drejtë t'i drejtohen direkt Gjykatës nëse pretendojnë se u është shkelur ndonjë e drejtë e garantuar me Konventën Europiane

Doracaku është hartuar në kuadër të projektit “Media për të gjithë - Përforcimi i Vetërregullimit të Mediave, të Drejtës së Mediave dhe Lirisë së Mediave në Kosovë 2014-2016” që është zbatuar nga Fondacioni Thomson dhe është financuar e menaxhuar nga Bashkimi European dhe Zyra e Bashkimit European në Kosovë. Gjatë trajnimeve të projektit janë referuar disa prej këtyre rasteve. Për shkak se ato kanë ngjallur interesimin e gjykatësve, prokurorëve, avokatëve, juristëve tjerë dhe komunitetit të gazetarëve, tani prezantohen të detajuara që të shfrytëzohen nga një audiencë potencialisht më e gjerë.



1. Hyrje

1.1 Disa shpjegime bazë rreth organizimit të Gjykatës dhe procedurës para saj

GjEDNj-ja është themeluar më 1959, gjashtë vjet pas hyrjes në fuqi të Konventës. Aktualisht Gjykata monitoron respektimin e të drejtave të njeriut të rreth 800 milionë banorëve të Palëve të Larta Kontraktuese (shteteve anëtare të KE-së) të cilat e kanë ratifikuar Konventën.

GjEDNj-ja i shqyrton rastet:

- i) në një trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar
- ii) në komitete me tre gjyqtarë
- iii) në Dhoma me shtatë gjyqtarë
- iv) në Dhomën e Madhe me shtatëmbëdhjetë gjyqtarë

Gjykata shqyrton çështje që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara me Konventë (neni 32.1 i Konventës). Ajo përbëhet nga një numër gjyqtarësh të barabartë më numrin e shteteve anëtare të KE-së (neni 20). Gjyqtarët zgjidhen nga Asambleja Parlamentare e KE-së në bazë të një liste prej tre kandidatësh të propozuar nga shtetet anëtare (neni 22).

Të drejtë të paraqesin çështje para Gjykatës kanë çdo person ose grup personash që pretendojnë të jenë viktimat e një shkeljeje nga shtetet nënshkruese (neni 34) dhe çdo shtet kundër shtetit tjetër, këto të fundit të njohura si kërkesat ndër-shtetërore (neni 19). Gjykata e trajton një çështje vetëm nëse janë shtetuar të gjitha mjetet e brendshme ligjore dhe brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data në të cilën është marrë vendimi [nga autoritetet vendore] i formës së prerë (neni 35.1).

Paraqitja e kërkesës para gjykatës bëhet duke plotësuar aplikacionin në gjuhën angleze ose franceze të shoqëruar me dokumentet e nevojshme, të cilat nuk duhet të jenë origjinale pasi që ato dokumente nuk i kthehen palës. Aplikacioni ndodhet në faqen zyrtare të Gjykatës. Aplikacionet të cilat nuk janë të plotësuara mirë mund të çojnë në papranueshmërinë e kërkesës. Palët mund, por nuk janë të obliguara, të angazhojnë avokatë në fillim të procedurës. Kërkesa duhet të dërgohet me postë në Gjykatë në Strasburg të Francës dhe palët nuk lejohen të kontaktojnë Gjykatën. Nëse një parashtrues i kërkesës paraqet kërkesë në emër të dy apo më shumë parashtruesve kërkesat e të cilëve bazohen në fakte dhe rrethana të ndryshme, për secilin parashtrues duhet të paraqitet një aplikacion i veçantë me dokumentet respektive të bashkëngjitura.



Çështjet e sjella para Gjykatës i nënshtrohen procedurës së pranueshmërisë së kërkesës dhe procedurës së shqyrtimit të meritave (themelit) të çështjes. Nëse një kërkesë individuale është paraqitur në formë anonime, ose është në thelb e njëjtë me një çështje të shqyrtuar më parë nga Gjykata, atëherë ajo kërkesë nuk merret në shqyrtim (neni 35.2). Nëse një kërkesë individuale nuk është në pajtueshmëri me Konventën ose Protokollet e saj, ose nëse kërkuesi nuk ka pasur ndonjë dëm të konsiderueshëm, atëherë ajo kërkesë shpallet e papranueshme (neni 35.3).

Varësisht nga rasti, ajo i shqyrton çështjet e sjella para saj në një trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, në komitete me tre gjyqtarë, në Dhoma me shtatë gjyqtarë dhe në Dhomën e Madhe me shtatëmbëdhjetë gjyqtarë (neni 26.1). Dhoma e Madhe është instanca e dytë dhe përfundimtare e GjEDNj-së.

Trupi gjykues i përbërë nga një gjyqtar mund ta deklarojë të papranueshëm ose të çregjistrojë një kërkesë kur një gjë e tillë është e qartë qysh në fillim dhe vendimi i saj është i formës së prerë (neni 27). Komiteti prej tre anëtarësh jep vendime ose aktgjykime finale në rastet për të cilat ekziston jurisprudencë e qartë (neni 28). Nëse vendimi nuk merret nga një gjyqtar ose komiteti prej tre anëtarësh, atëherë çështja bie në kompetencë të Dhomës së përbërë prej shtatë gjyqtarësh (neni 29).

Palët që nuk janë të kënaqura me vendimin e marrë nga komiteti prej tre gjyqtarësh apo Dhoma prej shtatë gjyqtarësh, në raste përjashtimore, mund të kërkojnë referimin e saj në Dhomën e Madhe (neni 43.1.). Po ashtu, Dhoma mund të heqë dorë nga juridiksioni i saj në favor të Dhomës së Madhe dhe rasti mund të vendoset drejtëpërsëdrejti nga Dhoma e Madhe (neni 30). Kërkesa e tillë pranohet në qoftë se çështja ngre një problem serioz që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e Konventës ose të protokolleve të saj, ose një çështje serioze të një rëndësie të përgjithshme (neni 43.2).

Gjykata e shqyrton çështjen së bashku me përfaqësuesit e palëve dhe nëse është e nevojshme ndërmerr një hetim (neni 38). Gjykata lejon edhe ndërhyrje nga palë të treta që mund të jenë shtetet anëtare, një person ose organizatë e interesuar në çështjen që trajtohet para gjykatës, ose Komisionari për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Europës (neni 36). Në çdo fazë të gjykimit, palët mund të zgjidhin çështjen me pajtim dhe gjykimi i tillë është konfidencial (neni 39).

Seancat janë publike dhe dokumentet e dorëzuara në sekretari janë të hapura për publikun, përveç rasteve kur Gjykata vendos ndryshe (neni 40). Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose Protokolleve të saj, atëherë palës së dëmtuar i caktohet një shpërblim i drejtë.

Shtetet anëtare të KE-së janë të obliguara që të respektojnë dhe të ekzekutojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës. Vendimi i formës së prerë i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili e mbikëqyrë ekzekutimin e tij dhe në rast refuzimi të ekzekutimit Komiteti i Ministrave rereferon rastin në Gjykatë, e cila përfundimisht vendos për masat që duhet të merren ndaj shtetit anëtar në fjalë.

2.

E drejta e qasjes në dokumente dhe informacione publike

2.1 Khurshid Mustafa dhe Tarzibachi kundër Suedisë

2.2 Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë

2.3 Kenedi kundër Hungarisë

2.4 Gillberg kundër Suedisë

2.5 Youth Initiative for Human Rights kundër Serbisë

2.6 Österreichische Vereinigung kundër Austrisë

2.7 Rosianu kundër Rumanisë

2.8 Guseva kundër Bullgarisë



Seancë gjyqësore e mbajtur nga Dhoma e Madhe (2015)
© Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut



2. E drejta e qasjes në Dokumente dhe Informacione publike

2.1 Khurshid Mustafa dhe Tarzibachi kundër Suedisë

Kërkesa nr. 23883/06, 16 mars 2009, Dhoma e Seksionit të Tretë

Parashtruesit e kërkesës, çifti i martuar më origjinë irakiane, kanë lindur më 1957 dhe 1963 ndërsa jetojnë në Västerås (Suedi). Ata kanë tre fëmijë të cilët në kohën e parashtrimit të kërkesës ishin tetëmbëdhjetë, gjashtëmbëdhjetë dhe tetëvjeçarë.

Më 1 nëntor 1999 çifti mori me qira një banesë në Rinkeby, një parlagje e Stokholmit. Kontrata e qirasë përfshinte obligimin sipas të cilit qiramarrësit nuk lejoheshin të instalonin “antenë apo diçka të llojit të tillë” dhe obligoheshin të mbanin “rend dhe të silleshin mirë.” Pasi kishin hyrë në banesë, ata kishin filluar të përdornin një antenë satelitore [në formë të pjatës] që ishte vendosur aty më herët për të shikuar programe televizive në gjuhën arabe dhe farsi. Pas ndërrimit të qiradhënësit, çiftit i ishte kërkuar që të largonin antenën satelitore. Atyre u ishte dhënë lajmërimi për ndërprerjen e kontratës mbi qiranë, pasi kishin dështuar ta largonin antenën. Edhe pse ata kishin zëvendësuar antenën satelitore me një antenë mobile [lëvizëse] që mund të vendosej në dritare, qiradhënësi kishte filluar procedurat gjyqësore për largimin e tyre nga banesa.

Gjykata e shkallës së parë kishte hedhur poshtë rastin në favor të çiftit, por gjykata e apelit i kishte dhënë të drejtë qiradhënësit. Sipas kësaj të fundit, bazuar në legjislacionin përkatës vendor, parashtruesit e kërkesës kishin neglizhuar obligimet e tyre deri në atë masë sa që kishin humbur të drejtën ta vazhdonin kontratën mbi qiranë. Qiramarrësi i kishte ofruar çiftit mundësinë që të rrinin në banesë nëse do ta largonin antenën mobile, gjë të cilën ata e kishin refuzuar dhe rrjedhimisht ishin detyruar të lironin banesën. Parashtruesit ushtruan kërkesë në GjEDNj për shkelje të së drejtës për të marrë informacion, të garantuar me nenin 10 të Konventës.

Qeveria e Suedisë konsideroi se padia ishte e papranueshme sipas *ratione materiae*, pasi që rasti përfshinte kontest kontraktor në mes të dy palëve private pa ndonjë intervenim nga autoritetet publike. GjEDNj-ja vlerësoi se gjykata vendore e apelit gjatë shqyritimit të rastit ishte lëshuar në vlerësim jo vetëm të kontratës mbi qiranë në mes të dy palëve, por edhe të legjislacionit përkatës vendor. Interpretimi i legjislacionit vendor nga kjo gjykatë e kishte bërë të ligjshëm trajtimin e kërkesës së ushtruar në GjEDNj, sepse pëfundimisht largimi i tyre nga banesa ishte rezultat i vendimit gjyqësor. Ky veprim ligjor ndërlidh shtetin e paditur me përgjegjësinë e caktuar me nenin 10 të Konventës. Rrjedhimisht, gjykatësit e shpallën kërkesën si të pranueshme në mënyrë



unanime. GjEDNJ-ja fillimisht konstatoi se ndërhyrja [nga shteti] ishte e parashikuar me ligj me qëllim mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Tutje, Gjykata shqyrtoi nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Antena satelitore u kishte mundësuar parashtruesve të kërkesës dhe tre fëmijëve të tyre qasjen në programe nga vendi i tyre i origjinës në gjuhën arabe dhe farsi. Ai informacion – që përfshinte lajme politike, sociale, kulturore dhe zbavitëse – ishte i një rëndësie të veçantë për ta si një familje emigrantësh që dëshironin të mbanin kontaktet me kulturën dhe gjuhën e tyre. Sipas Gjykatës, e drejta për të marrë informacion nuk nënkupton vetëm lajme që kanë të bëjnë me çështje publike, por përfshin edhe shprehjet kulturore, qofshin ato edhe vetëm zbavitëse. Parashtruesit e kërkesës nuk kishin në dispozicion mjete të tjera për t'u qasur këtyre programeve në atë kohë dhe as nuk mund të vendosnin antenën satelitore diku tjetër. As lajmet e marra nga gazetatat dhe radiot e huaja nuk mund të barazoheshin me informatat e ofruara përmes transmetimit televiziv. Shqetësimet e qiradhënësit rreth sigurisë ishin shqyrtuar nga gjykatat vendore të cilat kishin vërtetuar se vendosja e antenës satelitore nuk përbënte ndonjë kërcënim real të sigurisë. Po ashtu, nuk ishte dëshmuar se qiradhënësi kishte instaluar internet apo mjete tjera për t'u ofruar qiramarrësve mundësi të tjera të qasjes në programet televizive. Për më tepër, fakti që parashtruesit e kërkesës ishin larguar nga banesa së bashku me tre fëmijet e tyre në një qytet tjetër, dëshmoi se ndërhyrja ishte joproporcionale me qëllimin e ndjekur. Rrjedhimisht, ndërhyrja nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.



E drejta për të marrë informacion nuk nënkupton vetëm lajme që kanë të bëjnë me çështje publike, por përfshin edhe shprehjet kulturore, qofshin ato edhe vetëm zbavitëse.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)

2.2 Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë

Kërkesa nr. 37374/05, 14 korrik 2009, Dhoma e Seksionit të Dytë

Parashtruesja e kërkesës, Társaság a Szabadságjogokért, është organizatë e themeluar më 1994 me seli në Budapest që promovon të drejtat themelore, sundimin e ligjit dhe është aktive në fushën e politikave kundër drogës. Në mars 2004 një deputet i parlamentit hungarez kishte parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë për vlerësimin e kushtetshmërisë së disa neneve të kodit penal. Kërkesa fokusohej në vlerësimin e neneve



2.

E drejta e qasjes në Dokumente dhe Informacione publike

që rregullonin veprat penale të ndërlidhura me drogë. Disa muaj më vonë, organizata në fjalë kërkoi qasje në kërkesën e deputetit e cila ishte ende në procedurë para gjykatës kushtetuese. Kjo e fundit, pa u konsultuar me deputetin, refuzoi kërkesën për qasje nën arsyetimin se dokumenti i kërkuar nuk mund të bëhej publik pa aprovimin e autorit [deputetit].



Do të ishte fatale për lirinë e shprehjes në sferën politike nëse figurat publike do të mund të censuronin shtypin dhe debatin publik në emër të të drejtave të tyre personale.

Parashtruesja iu drejtua gjykatës regjionale së cilës i kërkoi që ta urdhëronte gjykatën kushtetuese të ofronte qasje në dokumentet e kërkuara në pajtim me Ligjin për të Dhëna të vitit 1992. Gjykata regjionale hodhi poshtë padinë e organizatës nën arsyetimin se kërkesa e deputetit e parashtruar në kushtetuese nuk mund të konsideroj si “e dhënë” dhe rrjedhimisht nuk mund të kërkohet qasje në të bazuar në Ligjin për të Dhëna. Gjykata e apelit, pasi konfirmoi vendimin e shkallës së parë, shtoi se kërkesa megjithatë kishte të “dhëna”, por që ishin “personale” dhe nuk mund të bëheshin të qasshme pa aprovimin e autorit. Sipas apelit, mbrojtja e këtyre të dhënave nuk mund të mos respektohej edhe nëse ishin në pyetje qëllime të tjera të ligjshme duke përfshirë qasjen në informacione publike. Ndërkohë, gjykata kushtetuese vendosi rreth vlerësimit të kushtetutshmërisë së neneve të kodit penal dhe publikoi një përmbledhje të kërkesës në vendimin e saj. Organizata iu drejtua Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut nën pretendimin se refuzimi i qasjes në dokumente përbën shkelje të nenit 10 të Konventës.

Lidhur me lirinë e shprehjes, GjEDNj-ja ritheksoi se publiku ka të drejtë të marrë informata me interes të përgjithshëm. Duke marrë parasysh natyrën e punës së organizatës që përfshin, inter alia, iniciativa strategjike gjyqësore në fushën e mbrojtjes së lirisë së informimit, gjykata e cilësoi parashtruesen e kërkesës si “mbikëqyrëse shoqërore” [social watchdog], aktivitetet e së cilës kërkojnë mbrojtje të njëjtë nga Konventa sikur ajo që i ofrohet shtypit. Për më tepër, kërkesa për rishikim abstrakt të kushtetutshmërisë, sidomos kur parashtrohet nga një deputet parlamenti, padyshim se përbën çështje në interes të publikut. Në rastin konkret, autoritetet kishin ndërhyrë në të drejtën e organizatës për të mbledhur informacione qysh në fazën e hershme, duke krijuar pengesa administrative dhe për shkak të monopolit të gjykatës kushtetuese në atë informacion, refuzimi i kërkesës për qasje në dokumente rezultoi me censurë.

Sa i përket meritave të rastit, Gjykata theksoi se e drejta e shtypit për të marrë informacion sipas nenit 10 të Konventës ua ndalon qeverive të kufizojnë marrjen e informacioneve. Rasti i parashtrueses duhet të konsiderohet si refuzim i qasjes në dokumente të një “mbikëqyrësi shoqëror” që është i barasvlershëm me shtypin, e jo si një mohim i thjeshtë i kërkesës për qasje në dokumente publike. Informacioni i kërkuar nga organizata ishte i gatshëm dhe në dispozicion dhe nuk kërkonte mbledhje të të dhënave nga qeveria. Në rrethana të tilla, shteti ishte i obliguar që të mos pengonte rrjedhjen e informacioneve të kërkuara nga parashtruesja e kërkesës. Kërkesa nuk kishte asnjë ndërlidhje me jetën private të deputetit në fjalë dhe do të ishte fatale për lirinë e shprehjes në sferën politike nëse figurat publike do të mund të censuronin shtypin dhe debatin publik në emër të të drejtave të tyre personale. Gjykata vlerësoi se pengesat e dizajnuara që të vështirësojnë qasjen në informacion me interes



publik mund të dekurajojnë ata që punojnë në media apo fusha të ndërlidhura që të kryejnë punën e tyre prej “mbikëqyrësi shoqëror” dhe rrjedhimisht do zvogëlonin mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme. Rrjedhimisht, ndërhyrja në të drejtën e organizatës për liri të shprehjes nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe përbënte cenim të nenit 10 të Konventës.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)

2.3 Kenedi kundër Hungarisë

Kërkesa nr. 31475/05, 26 gusht 2009, Dhoma e Seksionit të Dytë

Parashtruesi i kërkesës János Kenedi është shtetas i Hungarisë dhe banues në Budapest. Ai është historian i specializuar në funksionimin e shërbimeve sekrete në regjime diktatoriale, studime krahasuese të forcave politike në regjime totalitare dhe funksionim të shteteve të tipit sovjetik. Ai ka publikuar disa punime në këtë fushë. Më 21 shtator 1999, ai i kërkoi Ministrisë së Punëve të Brendshme të Hungarisë qasje në disa dokumente, pasi që planifikonte të publikonte një studim rreth funksionimit të Shërbimit Sekret Shtetëror të Hungarisë në vitet '60.

Fillimisht kërkesa e tij ishte refuzuar nën arsyetimin se dokumentet ishin të klasifikuara si sekrete shtetërore. Më pas, një gjykatë regjionale kishte urdhëruar lejimin e qasjes së pakufizuar, pasi parashtruesi i kërkesës kishte argumentuar se dokumentet ishin të nevojshme për studimin e tij në fushën e historisë. Pasi humbi rastin në disa instanca duke përfshirë edhe në gjykatën supreme, ministria ofroi qasje me kusht që parashtruesi të nënshkruante marrëveshje konfidencialiteti. Parashtruesi i kërkesës refuzoi të nënshkruante marrëveshjen në fjalë dhe inicioi procedurë për ekzekutimin e aktgjykimit të gjykatës supreme. Tetë vjet pas parashtrimin të kërkesës fillestare dhe përkundër ankesave të përsëritura në gjykata, ministria duke përdorur argumente të ndryshme nuk i kishte lejuar qasje të pakufizuar parashtruesit në dokumentet e kërkuara. Për këtë arsye, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar GjEDNj-së nën pretendimin se moszbatimi i aktgjykimit nga ministria brenda një kohe të arsyeshme përbën shkelje të nenit 10 të Konventës. Ai shtoi se si rezultat i dredhive të ministrisë ishte penguar në publikimin e një studimi objektiv për Shërbimin Sekret të Sigurisë së Hungarisë.

Qeveria pranoi se kishte ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes së profesorit, porse faji ishte i tij që nuk kishte pranuar qasje të kufizuar në dokumente. Parashtruesi



2. E drejta e qasjes në Dokumente dhe Informacione publike



Qasja në dokumentet origjinale për qëllime studimore-historike përbën një element bazik në ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes.

i kërkesës kishte siguruar një aktgjykim që i lejonte qasje në dokumente, porse konflikti kishte lindur rreth nivelit të qasjes në dokumentet e kërkuara. GjEDNj vërejtë se gjykatat vendore kishin vendosur vazhdimisht në favor të parashtruesit të kërkesës dhe e kishin gjorbitur ministrinë disa herë në përpjekje për ta detyruar atë ta zbatonte aktgjykimin. Në këto rethana, Gjykata konkludoi se mungesa e gatishmërisë së autoriteteve vendore që të zbatojnë një aktgjykim, në këtë rast të ministrisë në fjalë, ishte në kundërshtim me legjislacionin vendor dhe i barasvlefshëm me arbitraritet. Qasja në dokumentet origjinale për qëllime studimore-historike përbën një element bazik në ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes së parashtruesit dhe rrjedhimisht kishte shkelje të së drejtës për liri të shprehjes të garantuar me nenin 10 të Konventës.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)

2.4 Gillberg kundër Suedisë

Kërkesa nr. 41723/06, 3 prill 2012, Dhoma e Madhe

Parashtruesi i kërkesës Christopher Gillberg, i lindur më 1950 është shtetas suedez dhe banor në Gothenburg. Në atë kohë ai ishte profesor në Universitetin e Gothenburg-ut dhe përgjegjës për një projekt hulumtues rreth çrregullimeve të fëmijëve me hiperaktivitet dhe mungesë të vëmendjes. Projekti hulumtues ishte zhvilluar në mes të viteve 1977 – 1992. Sipas parashtruesit të kërkesës, komisioni i etikës së universitetit në fjalë e kishte caktuar si parakusht që në materialet e ndjeshme për pjesëmarrësit e hulumtimit do të kishte qasje vetëm ai dhe ekipi hulumtues. Për këtë arsye, pacientëve të vegjël dhe prindërve të tyre u ishte premtuar konfidencialitet absolut.

Më 2002, një hulumtues nga një universitet tjetër dhe një pediatër kërkuan qasje në materialin hulumtues në fjalë. Pasi kërkesat e tyre për qasje në dokumente ishin refuzuar nga universiteti, ata parashtruan padi në gjykatën administrative, e cila vendosi në favor të tyre. Gjykata e njohu interesin legjitim të tyre dhe ofroi qasje të kufizuar në përdorimin e materialit, me kusht që hulumtuesit nuk mund të nxirrin kopje të hulumtimit jashtë ambienteve të universitetit. Por, përkundër vendimit të gjykatës, profesori refuzoi të ofronte edhe atë qasje të lejuar nga gjykata dhe materiali u shkatërrua më vonë nga disa kolegë të tij në universitet. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, parashtruesi u ndoq penalisht dhe u dënua për keqpërdorim të pozitës zyrtare me kusht dhe gjobë prej rreth 4,000 eurosh. Dënimin e tij e kishte konfirmuar edhe gjykata e apelit, e cila vendosi që ai qëllimisht kishte shpërfillur obligimin e tij zyrtar kur vendosi të mos zbatonte aktgjykimet e gjykatës së apelit dhe gjykatës administrative.



Parashtruesi i kërkesës iu drejtua GjEDNJ-së nën pretendimin se neni 10 i Konventës ia mundësonte atij të drejtën negative që të mos e jepte materialin hulumtues. Ai tutje theksoi se pacientëve u kishte premtuar konfidencialitet dhe po mendohej të ruante integritetin e tyre. Sipas tij, situata në të cilën ndodhej ishte e krahasueshme me obligimin e konfidencialitet që avokatët kanë ndaj klientëve të tyre. Më 2 dhjetor 2010 shkalla e parë e GjEDNJ-së kishte vendosur se nuk kishte pasur shkelje të neneve 8 dhe 10 të Konventës, porse nuk e kishte elaboruar përgjigjen nëse kërkesa binte në fushëveprimin e këtyre neneve. Për këtë arsye, parashtruesi kërkoi referim të rastit në Dhomën e Madhe të GjEDNJ-së.

Gjatë shqyrtimit, Dhoma e Madhe gjeti se neni 10 përfshinte edhe të drejtën negative [mosndërhyrjen në të drejtën e lirisë së shprehjes]. Në rastin konkret, materiali të cilin parashtruesi refuzoi ta vinte në dispozicion të hulumtuesve tjerë i përkiste universitetit, ishte material publik dhe rrjedhimisht ishte subjekt i ligjeve vendore për qasje në dokumente publike. Sipas legjislacionit vendor, autoritetet publike nuk kishin të drejtë të lidhnin marrëveshje paraprake me palë të treta me qëllim të privimit të së drejtës së publikut për dokumente publike. Për këtë arsye gjykatat vendore kur dënuan parashtruesin e kërkesës konstatuan që ai u kishte ofruar konfidencialitet palëve në hulumtim më shumë sesa që lejohente ligji. Parashtruesi i kërkesës nuk kishte ofruar ndonjë provë apo argument bindës që të mbështeste pretendimet e tij se sigurimi i konfidencialitetit të pjesëmarrësve në hulumtim kishte qenë kërkesë e komisionit për etikë të universitetit. Në fakt, parashtruesi nuk ishte penguar që të ekzekutonte aktgjykimet e gjykatave nga ndonjë obligim ligjor për konfidencialitet apo ndonjë urdhër tjetër nga punëdhënësi i tij publik. Veprimi i tij ishte bazuar në besimin e tij që aktgjykimet ishin të gabueshme. Në këto rrethana, pyetja kryesore që u shtrua para Dhomës së Madhe ishte nëse parashtruesi si punëtor publik kishte ndonjë të drejtë negative sipas nenit 10 që e lejonte atë të mos e bënte të qasshëm materialin hulumtues, edhe pse materiali nuk i takonte atij, por universitetit. Gjykata përmendi faktin se universiteti dëshironte të zbatonte aktgjykimet e gjykatave administrative dhe të lejonte profesorin dhe pediatrin të kishin qasje në materialet e kërkuara.

Sipas Gjykatës, vendimi që parashtruesi i kërkesës të gëzonte të drejtën “negative” do të ishte në kundërshtim me të drejtat e autorit të universitetit dhe do të nënvlerësonte të drejtën e dy hulumtuesve tjerë që të kishin qasje në informacione. Gjykata vërejti gjithashtu se situata në të cilën ndodhej parashtruesi i kërkesës nuk mund të krahasohej me atë të gazetarit në kuptim të mbrojtjes së burimeve, pasi që informatat e një burimi të gazetarit zakonisht i takojnë gazetarit ose mediumit, ndërsa në rastin e parashtruesit në fjalë materiali hulumtues i takonte universitetit dhe ishte në domenin publik. Për më tepër, meqenëse ai nuk ishte mandatuar nga pjesëmarrësit e hulumtimit si doktor i tyre, atëherë ai nuk kishte obligim karshi tyre për ruajtje të sekretit profesional. Për këto arsye, të drejtat e tij të garantuara me nenin 10 nuk ishin cenuar dhe rrjedhimisht ky nen nuk ishte i zbatueshëm në këtë rast.



Vendimi që parashtruesi i kërkesës të gëzonte të drejtën “negative” do të ishte në kundërshtim me të drejtat e autorit të universitetit dhe do të nënvlerësonte të drejtën e dy hulumtuesve tjerë që të kishin qasje në informacione.

Vendimi: Neni 10 nuk është i aplikueshëm në këtë rast (në mënyrë unanime)



2. E drejta e qasjes në Dokumente dhe Informacione publike

2.5 Youth Initiative for Human Rights kundër Serbisë

Kërkesa nr. 48135/06, 25 shtator 2013, Dhoma e Seksionit të Dytë

Parashtruesja e kërkesës Youth Initiative for Human Rights [YIHR] me seli në Beograd, është organizatë joqeveritare e cila monitoron zbatimin e ligjeve tranzicionale me qëllim të sigurimit të respektimit të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit.



Kur një organizatë joqeveritare, siç ishte rasti i YHIR-së, përfshihet në çështje të interesit publik, ajo e ushtron rolin e saj prej mbikëqyrësi publik njëjtë sikurse që bën shtypi.

Më 31 tetor 2005 YIHR-ja kishte kërkuar nga Agjencia e Serbisë për Inteligjencë që ta informonte për numrin e personave të përgjuar nga kjo agjenci gjatë vitit 2005. Duke u bazuar në Ligjin për Lirinë e Informimit 2004, agjencia refuzoi kërkesën për qasje në informacion, pasi sipas këtij ligji qasja në dokumente publike mund të refuzohet nëse dokumenti është klasifikuar zyrtarisht si dokument sekret dhe nëse publikimi i atij dokumenti do të nënvlerësonte interesat legjitimë të cilët kanë prioritet karshi lirisë së informimit. YIHR-ja u ankua tek Komisionari për Informim i cili gjeti që agjencia kishte shkelur ligjin në fjalë dhe e urdhëroi atë t'i ofrojë qasje parashtrueses në informacionet e kërkuara brenda tri ditësh. Ankesa e agjencisë së inteligjencës ishte hedhur poshtë. Në tetor 2008 agjencia e inteligjencës e informoi YHIR-në se nuk e posedonte informacionin e kërkuar.

Parashtruesja e kërkesës u ankua në GjEDNj, bazuar në nenin 10 të Konventës, nën pretendimin se Agjencia e Serbisë për Inteligjencë ia kishte mohuar qasjen në informacione që kishin të bënin me përgjime elektronike, pavarësisht vendimit final të Komisionarit për Informim. GjEDNj-ja ritheksoi se nocioni i “lirisë për të marrë informacion” sipas nenit 10 të Konventës përfshin edhe të drejtën për qasje në informacion. Kur një organizatë joqeveritare, siç ishte rasti i YHIR-së, përfshihet në çështje të interesit publik, ajo e ushtron rolin e saj prej mbikëqyrësi publik njëjtë sikurse që bën shtypi. Për këtë arsye, aktivitetet e parashtrueses meritojnë mbrojtje nga Konventa, njëjtë siç meriton shtypi. Meqenëse parashtruesja ka qenë e përfshirë në mbledhjen legjitime të informacioneve me interes publik, moslejimi i qasjes përbën ndërhyrje në të drejtën e parashtrueses për liri të të shprehurit.

Ushtrimi i lirisë së të shprehurit mund të kufizohet, por ky kufizim duhet të jetë në përputhje me legjislacionin vendor. Kufizimet e vëna nga Agjencia Serbe për Inteligjencë



nuk e përmbushnin këtë kriter. Institucioni vendor i caktuar që të vendosë për zbatimin e Ligjit për Lirinë e Informimit 2004 pasi kishte shqyrtuar rastin kishte vendosur që informacioni i kërkuar duhej t'i ofrohej YIHR-së. Edhe pse agjencia e inteligjencës dikur ishte përgjigjur duke thënë se nuk e posedonte informacionin e kërkuar, përgjigjja nuk ishte bindëse. Si rezultat, hezitimi këmbëngulës i Agjencisë së Serbisë për Inteligjencë që të vepronte në pajtim me urdhrin e Komisionarit për Informim ishte në kundërshtim me legjislacionin vendor dhe i barasvlershëm me arbitraritet. Rrjedhimisht përbënte cenim të nenit 10 të Konventës.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime).

2.6 Österreichische Vereinigung kundër Austrisë

Kërkesa nr. 39534/07, 28 shkurt 2014, Dhoma e Seksionit të Parë

Emri i plotë i parashtrueses së kërkesës është: Österreichische Vereinigung zur Erhaltung, Strärkung und Schaffung Eines Wirtschaftlich Gesunden Land- und Forstwirtschaftlichen Grundbesitzes.

Parashtruesja e kërkesës është organizatë e regjistruar dhe me seli në Vjenë, e cila në atë kohë merrej me hulumtime dhe studime rreth ndikimit në shoqëri të transferimit të pronësisë së tokës bujqësore dhe malore dhe ofronte opinione në draftligje të ndërlidhura me këtë sferë. Proceduralisht, transaksionet pronësore kërkonin aprovim nga autoritet lokale dhe regjionale për të siguruar mbrojtjen e tokës bujqësore dhe malore. Autoritetet përgjegjëse për lëshimin e këtij aprovimi ishin Komisionet Regjionale për Transaksione të Patundshmërive. Në prill 2005, parashtruesja e kërkesës kërkoi nga Komisioni Regjional i Tirolit për Transaksione të Patundshmërive që t'ia dërgonte me postë kopjet e të gjitha vendimeve që kishte lëshuar që nga fillimi i atij viti. Organizata pranoi që detajet e palëve të përfshira mund të anonimizoheshin dhe ofroi të rimbursonte shpenzimet e bëra. Më vonë organizata paraqiti edhe një kërkesë me të cilën kërkoi qasje në vendimet e lëshuara që nga viti 2000 duke argumentuar që këto vendime duhej të bëheshin publike në cilëndo mënyrë të mundshme. Komisioni refuzoi kërkesën për qasje për shkak të mungesës së kohës dhe stafit dhe argumentoi se informatat e kërkuara nga parashtruesja nuk përbënin informacion sipas legjislacionit për qasje në dokumente publike, vendim ky që ishte konfirmuar nga gjykatat vendore. E pakënaqur me aktgjykimin e gjykatave vendore, parashtruesja e kërkesës iu drejtua GjEDNJ-së nën pretendimin se refuzimi i qasjes në dokumentet e kërkuara përbënte shkelje të nenit 10 të Konventës.



2. E drejta e qasjes në Dokumente dhe Informacione publike

GjEDNj-ja fillimisht vlerësoi se refuzimi i kërkesës së parashtrueses për qasje në vendimet e komisionit përbënte ndërhyrje në të drejtën e saj për të marrë dhe dhënë informata sipas nenit 10 të Konventës. Ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj me qëllim legjitim për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve. Gjykata kujtoi se në rastin *Társaság a Szabadságjogokért* kishte bërë progres në zgjerimin e interpretimit të nocionit të “lirisë për të marrë informacion” duke përfshirë edhe të drejtën e qasjes në informacione. Sipas Gjykatës, në rastet kur autoritetet gëzojnë monopol në informacione siç ishte rasti në fjalë, ajo duhet të ushtrojë mbikëqyrje edhe më të kujdesshme.

Gjykata nuk u pajtua me interpretimin e parashtrueses së kërkesës sipas të cilit neni 10 nënkupton që duhet të ekzistojë një obligim i përgjithshëm që të publikohen të gjitha vendimet në një databazë elektronike ose të ofrohen kopje të tyre sipas kërkesës. Por ajo shqyrtoi nëse arsyet e refuzimit të ofruara nga autoritetet vendore ishin relevante dhe të mjaftueshme në rastin konkret. Kërkesa nuk kishte të bënte me një dokument

të veçantë, por me një seri dokumentesh të lëshuara gjatë një kohe të caktuar. Për më shumë, nevoja për të anonimizuar vendimet dhe dërgimi i kopjeve organizatës në fjalë kërkonte resurse. Gjykata mori parasysh se organizata kishte pranuar që të dhënat personale mund të largoheshin nga vendimet dhe kishte ofruar rimbursim të shpenzimeve për të përgatitur dhe dërguar me postë dokumentet e kërkuara. Po ashtu, ishte e habitshme që asnjë nga vendimet e komisionit nuk ishte publikuar elektronikisht, apo në ndonjë formë tjetër. Rrjedhimisht, vështirësia së cilës i referohej komisioni ishte krijuar nga vetë ai institucion duke zgjedhur që të mos publikojë asnjë vendim të tij. Pra, arsyet e autoriteteve vendore për të refuzuar

kërkesën e parashtrueses që të ketë qasje në vendimet e komisionit ishin relevante, por jo të mjaftueshme. Ndonëse nuk është përgjegjësi e Gjykatës që të vendosë se në çfarë forme duhet të ofrojë qasje në vendime komisioni në fjalë, ajo gjeti se refuzimi i tërësishëm ishte joproporcional dhe nuk mund të konsiderohej si i nevojshëm në një shoqëri demokratike.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (gjashtë vota në favor dhe një kundër)



Ishte e habitshme që asnjë nga vendimet e komisionit nuk ishte publikuar elektronikisht, apo në ndonjë formë tjetër. Vështirësia së cilës i referohej komisioni ishte krijuar nga vetë ai institucion duke zgjedhur që të mos publikojë asnjë vendim të tij.



2.7 Rosiiianu kundër Rumanisë

Kërkesa nr. 27329/06, 24 shtator 2014, Dhoma e Seksionit të Tretë

Parashtruesi i kërkesës, Ioan Romeo Roșiiianu është i lindur më 1969 dhe banon në qytetin Baia Mare. Në atë kohë ishte gazetar dhe kishte prezantuar për gjashtë vjet me radhë një program në një televizion lokal të qytetit Baia Mare. Emisioni trajtonte çështje të ndryshme duke përfshirë shpenzimet e fondeve publike nga administrata komunale e qytetit. Me qëllim që të ushtronte profesionin e tij, parashtruesi i kërkesës e kishte kontaktuar kryetarin e komunës së cilit i kishte kërkuar qasje në informacione publike. Kërkesat i kishte bërë pasi ishte larguar nga puna, ndërsa emisioni i tij ishte zëvendësuar me një emision të financuar nga komuna e Baia Mare. Gazetari kishte parashtruar tri kërkesa në tematika të ndryshme dhe kryetari i ishte përgjigjur shkurt përmes tri letrave. Meqë letrat nuk përmbanin përgjigjet e kërkuara, gazetari parashtroi tri padi para gjykatës administrative në përpjekje për të marrë një urdhëresë gjyqësore që do të obligonte kryetarin e komunës që të ofronte informacionet e kërkuara. Në të tri rastet, gjykata vendosi në favor të gazetarit dhe urdhëroi kryetarin të ofronte qasje në informacionet e kërkuara. Kryetari i komunës refuzoi të zbatonte vendimet. Gjykata e apelit, duke konfirmuar vendimet për lejimin e qasjes në dokumente, po ashtu obligoi kryetarin t'i paguante kompensim dëmi gazetarit. Kur vendimet e gjykatës nuk u zbatuan pas disa përpjekjeve ligjore, gazetari iu drejtua GjEDNJ-së, bazuar në të drejtat e tij të garantuara me nenin 10 të Konventës.

Parashtruesi i kërkesës kishte siguruar tri aktgjykimet përfundimtare që urdhëronin kryetarin e komunës të ofronte qasje në informatat e kërkuara e të cilat ishin të natyrës publike. Gjykatat vendore kishin vendosur që letrat të cilat ftonin gazetarin të shkante dhe t'i merrte kopjet e disa dokumenteve që përmbanin disa informata ishin të hapura ndaj interpretimeve të ndryshme, por nuk mund të konsideroheshin si ekzekutim i mirëfilltë i aktgjyqimeve në fjalë. Për më tepër, Gjykata nuk mund të konstatonte nëse dokumentet e përmendura në ato letra përmbanin informacionin e kërkuar nga parashtruesi i kërkesës, pasi që qeveria dështoi të paraqiste letrat, ose një përmbledhje të tyre para GjEDNJ-së. Gjykata e kishte parasysh që nuk mund të kërkonte nga shteti të ekzekutonte të gjitha aktgjykimet në rastet civile, pa marrë parasysh natyrën dhe rrethanat e tyre. Sidoqoftë, autoriteti në fjalë ishte pjesë e administratës komunale që është pjesë e shtetit dhe i cili është subjekt i sundimit të ligjit. Kur një autoritet refuzon ose dështon, qoftë edhe duke u vonuar të vërë në vend



Kur një autoritet refuzon ose dështon, qoftë edhe duke u vonuar të vërë në vend drejtësinë, atëherë ky veprim është në kundërshtim me garancionet e parashtruesit gjatë shqyrtimeve gjyqësore të siguruara me Konventë.



2.

E drejta e qasjes në Dokumente dhe Informacione publike

drejtësinë, atëherë ky veprim është në kundërshtim me garancionet e parashtruesit gjatë shqyrtimeve gjyqësore të siguruara me Konventë. Për më tepër, ishte e papërshtatshme të kërkohej nga një individ që tashmë kishte fituar aktgjykime kundër shtetit, të përkujdesej edhe për procedura shtesë për zbatimin e aktgjykimeve. Gjykata theksoi se kur informacioni i kërkuar është në dispozicion, qasja mund të refuzohet vetëm në rastet kur vlejnë kufizimet e paragrafit të dytë të nenit 10. Meqë nuk kishte ndonjë argument adekuat për refuzimin e kërkesës së gazetarit në fjalë, Gjykata vendosi se atij i ishte cenuar e drejta për qasje në informacione të garantuar me nenin 10 të Konventës.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)

2.8 Guseva kundër Bullgarisë

Kërkesa nr. 6987/07, 6 korrik 2015, Dhoma e Seksionit të Katërt

Parashtruesja e kërkesës, Lyubov Viktorovna Guseva, e lindur më 1951 është shtetase bulgare dhe banuese në Vidin. Në atë kohë ajo ishte anëtare e Bordit të Drejtorëve të Organizatës për Mbrojtjen e Kafshëve në Vidin dhe e autorizuar të përfaqësonte organizatën para të gjitha institucioneve në Bullgari. Ajo kishte parashtruar në komunë tri kërkesa për qasje në dokumente dhe informacione publike që kishin të bënin me trajtimin e qenve të humbur. Pas refuzimit të kryetarit që të ofronte qasje në dokumentet e kërkuara, ajo ushtroi tri padi për të siguruar qasjen në dokumente dhe gjykatat vendosën në favor të saj. Kryetari i komunës nuk veprroi siç detyrohej bazuar në aktgjykimet e plotfuqishme dhe përsëri refuzoi qasjen. Pas disa përpjekjeve ligjore për të gëzuar ekzekutimin e aktgjykimeve, parashtruesja e kërkesës iu drejtua GjEDNj-së nën pretendimin se refuzimi i kryetarit për të ofruar qasje në dokumentet e kërkuara përbën shkelje të së drejtës për të marrë dhe dhënë informacione të garantuara me nenin 10 të Konventës.

GjEDNj-ja pohoi se parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar qasje në informacione rreth trajtimit të kafshëve me qëllim që të informonte publikun me këtë çështje me interes të përgjithshëm dhe që të kontribuonte në debat publik. E drejta e saj për të pasur qasje në dokumentet e kërkuara ishte e parashikuar me legjisilacion vendor dhe me tre aktgjykime të plotfuqishme të Gjykatës Supreme Administrative. Mbledhja e informacioneve me qëllim që t'ia ofronte publikut bie në fushëveprimin e të drejtës së parashtrueses për liri të shprehjes. Edhe pse parashtruesja kishte ushtruar paditë në kapacitetin e saj individual dhe jo në emër të organizatës që ajo përfaqësonte, informacionet të cilat ajo i kërkonte ishin të ndërlidhura me punën e saj në organizatë. Dështimi i kryetarit që të vepronte në përputhje me aktgjykimet e plotfuqishme duke mos i ofruar qasje në informacionin e kërkuar përbënte ndërhyrje në të drejtën e saj për të marrë dhe dhënë informacione.



Po ashtu, dështimi i kryetarit të komunës që të vepronte në pajtim me aktgjykimet e plotfuqishme, ishte veprim i paligjshëm. Mirëpo duke marrë parasysh se sipas praktikës vendore gjyqësore afati kohor për ekzekutimin e aktgjykimit nuk ishte i përcaktuar me ligj, kjo mbetej në vullnetin e mirë të institucioneve administrative përgjegjëse që të zbatonin aktgjykimet. Mungesa e afatit kohor për ekzekutimin e aktgjykimeve krijoi mundësinë që të mos mund të parashikohej me ligj koha e ekzekutimit të aktgjykimeve që lejonin qasje në dokumente, që në rastin e parashtrueses së kërkesës nuk ndodhi asnjëherë. Prandaj, legjislacioni vendor nuk e kishte të parashikuar me ligj parashikueshmërinë e ndërhyrjes, ashtu siç kërkohet me nenin 10 të Konventës.



Mungesa e afatit kohor për ekzekutimin e aktgjykimeve krijoi mundësinë që të mos mund të parashikohej me ligj koha e ekzekutimit të aktgjykimeve që lejonin qasje në dokumente.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (pesë vota në favor dhe dy kundër)



Searcë gjyqësore e mbajtur nga Dhoma e Madhe (2013)
Rasti: Vallianatos dhe të tjerët kundër Greqisë
Foto: Ellen Wuibaux, © Këshilli i Europës

3.

E drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetareve

-
- 3.1 Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar
 - 3.2 Roemen dhe Schmit kundër Luksemburg
 - 3.3 Ernst dhe të tjerët kundër Belgjikës
 - 3.4 Voskuil kundër Holandës
 - 3.5 Tillack kundër Belgjikës
 - 3.6 Financial Times dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar
 - 3.7 Sanoma Uitgevers kundër Holandës
 - 3.8 Ressiot dhe të tjerët kundër Francës
 - 3.9 Martin dhe të tjerët kundër Francës
 - 3.10 Telegraaf Media Nederland Landelijke Media B.V. dhe të tjerët kundër Holandës
 - 3.11 Saint-Paul Luxembourg kundër Luksemburgut
 - 3.12 Nagla kundër Letonisë
-



Seancë gjyqësore e mbajtur nga Dhoma e Madhe (2016)
© Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut



3. E drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetarëve

3.1 Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar

Kërkesa nr. 17488/90, 27 mars 1996, Dhoma e Madhe

Parashtruesi i kërkesës, William Goodwin, është shtetas anglez dhe banues në Londër. Më 1989 ai filloi të punonte si gazetar në “The Engineer.”



Mbrojtja e burimeve të gazetarëve përbën një ndër kriteret themelore për lirinë e shtypit dhe pa këtë mbrojtje burimet mund të hezitojnë të ndihmojnë gazetarët që të informojnë publikun për çështje me interes publik.

Atë vit një burim i mëhershëm i gazetarit i kishte ofruar informata përmes telefonit për kompaninë Tetra Ltd, e cila po aplikonte për një kredi prej 5 milionë funtash për shkak të humbjeve të papritura në fitim prej 1.2 milionë funtash. Kompania pretendonte që informatat e botuara rrjedhnin nga një draft-dokument konfidencial që ishte zhdukur nga zyra e financierit të kompanisë. Gazetari nuk kishte paguar për informatën e marrë dhe nuk kishte arsye të besonte që ajo informatë vinte nga dokumente të vjedhura ose konfidenciale, andaj edhe përgatiti një artikull për publikim. Kompania parashtrroi në gjykatë kërkesë për masë të përkohshme në mënyrë që të ndalonte gazetarin të publikonte ndonjë material që rridhte nga dokumenti në fjalë. Gjykatat vendore, në disa instanca, vendosën në favor të kompanisë dhe urdhëruan gazetarin që të zbulonte burimin. Sipas gjykatës vendore, zbulimi i burimit ishte më rëndësi për të ndaluar dëmin që do të pësonte kompania nëse lajmi do të vazhdonte të shpërndahej. Gazetari refuzoi të zbatonte aktgjykimet e të gjitha instancave gjyqësore që e urdhëronin atë të zbulonte burimin e informacionit. Si pasojë, ai u dënua me gjobë prej 5,000 funtash për mospërfillje të gjykatës.

Ai iu drejtua GjEDNj-së nën pretendimin se zbulimi i identitetit të burimeve të gazetarëve është në kundërshtim me të drejtën e lirisë së shprehjes të garantuar me nenin 10 të Konventës. Gjatë shqyrtimit të rastit, fillimisht GjEDNj-ja gjeti që nuk ishte diskutabil fakti që masat e ndërmarra kundër tij përbënin ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes siç garantohet me nenin 10 të Konventës. Ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe ishte bërë për arsye legjitime, meqë synonte mbrojtjen e të drejtave të kompanisë Tetra. Gjykatës i mbetej të vlerësonte nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Sipas gjykatës, mbrojtja e burimeve të gazetarëve përbën një ndër kriteret themelore për lirinë e shtypit dhe pa këtë mbrojtje burimet mund të hezitojnë të ndihmojnë gazetarët që të informojnë publikun për çështje me interes publik. Tutje, gjykata vlerësoi se pa mbrojtje të burimeve, roli mbikëqyrës i shtypit mund të nënvlerësohet dhe po ashtu mund të afektohet negativisht mundësia e shtypit që të ofrojë informata të besueshme



dhe të sakta. Për këto arsye, kufizimet në mbrojtjen e burimeve të gazetarëve kërkojnë mbikëqyrje shumë të kujdesshme. Në rastin konkret, të gjitha gazetat dhe gazetarët ishin njoftuar për urdhrin për zbulimin e burimit të gazetarit dhe masa e përkohshme ishte efektive për ndalimin e përhapjes së informacioneve konfidenciale të kompanisë përmes mediave. Rrjedhimisht, klientët dhe bashkëpunëtorët e kompanisë nuk do të informoheshin përmes shtypit dhe interesi vital i kompanisë ishte neutralizuar përmes masës së përkohshme. Urdhri për zbulimin e burimit shërbeu thjesht për të përforcuar masën e përkohshme dhe nuk ishte i arsyetuar mjaftueshëm siç kërkohet me paragrafin e dytë të nenit 10 të Konventës.

Gjykatat vendore theksuan se qëllimi legjitim i ndjekur me urdhrin për zbulimin e burimeve ishte zbulimi dhe largimi nga puna i punëtorit ose bashkëpunëtorit të pabesë, i cili ende ka mundur të ketë qasje në informatat e kompanisë. GjEDNj-ja e pranoi këtë argument si relevant, mirëpo nuk mundi të pranojë se interesi për mbrojtjen e kompanisë përmes veprimeve kundër burimit të gazetarit tejkalonte interesin vital të publikut në mbrojtjen e burimit të gazetarit. Sipas Gjykatës, qëllimi i ndjekur me urdhrin për zbulimin e burimeve dhe mjeteve të përdorura për të arritur atë qëllim nuk ishte proporcional. Për këto arsye, gjykata vendosi që urdhi për zbulimin e identitetit të burimit të gazetarit nuk ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike dhe së bashku me detyrimin për të paguar gjobë përbënin shkelje të së drejtës së tij për t'u shprehur të garantuar me nenin 10 të Konventës.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (11 vota në favor dhe 7 kundër)

3.2 Roemen dhe Schmit kundër Luksemburg

Kërkesa nr. 51772/99, 25 maj 2003, Dhoma e Seksionit të Katërt

Parashtruesit e kërkesës, Robert Roemen gazetar dhe Anne-Marie Schmit avokate janë shtetas dhe banues në Luksemburg. Në korrik 1999 parashtruesi i parë publikoi një shkrim në gazetën ditore Lëtzebuenger Journal sipas të cilit një ministër kishte bërë mashtrim me taksa me ç'rast i ishte shqiptuar një gjobë fiskale. Për të mbështetur pretendimet e tij, gazetari paraqiti disa dokumente si prova, në veçanti një vendim të Departamentit për Mbledhjen e Tatimeve që urdhëronte ministrin të paguante gjobën në fjalë, ndërsa gjoba ishte lëshuar para publikimit të shkrimit. Pas padisë penale nga ministri, ishte iniciuar një hetim kundër gazetarit për fshehje të veprës penale zbulim i



3. E drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetarëve

sekretit profesional të një apo më shumë personave të panjohur. Vendimi i prokurorit publik për të filluar hetimet theksonte se qëllimi i hetimit ishte të zbulohej se cilët zyrtarë të Departamentit për Mbledhjen e Tatimeve kishin qasje në dokumente e publikuara.

Dy kontrollimet e para të urdhëruara nga një gjykatës hetues - një në shtëpinë e gazetarit dhe një në vendin e tij të punës ishin të padobishme dhe veprimet parashtruesve të kërkesës për anulimin e urdhrave ishin të pasuksesshme. Gjatë kontrollimit të zyrës së parashtrueses së dytë, që ishte avokatja e gazetarit, zyrtarët sekuestrovan një letër konfidenciale nga drejtori i Departamentit për Mbledhjen e Tatimeve që mbante datë më të vonshme se ajo e publikimit të shkrimit. Gazetari dhe avokatja sqaruan se letra u ishte dërguar në mënyrë anonime redaktorëve të gazetës ku punonte gazetari dhe se ai ia kishte përcjellë atë menjëherë avokates së tij. Meqë kontrollimet ishin shpalluar të paligjshme, dokumenti iu kthye parashtruesve të kërkesës. Por në të njëjtën ditë, një urdhër i ri për kontrollim nga gjykatësi hetues mundësoi që letra të sekuestrohet përsëri. Parashtruesi i parë i kërkesës iu drejtua GjEDNj-së nën pretendimin se e drejta e tij që si gazetar të refuzojë zbulimin e identitetit të burimit të garantuar me nenin 10, ishte cenuar përmes ushtrimit të kontrollimeve nga autoritetet. Edhe avokatja pretendoi shkelje të nenit 8 të Konventës.



Kontrollimet me qëllim të identifikimit të burimeve të gazetarëve, edhe pse të padobishme, përbëjnë një veprim shumë më serioz sesa një urdhër për të zbuluar identitetin e burimeve.

GjEDNj-ja konstatoi se kontrollimet e bëra në shtëpinë dhe vendin e punës së parashtruesit të parë me qëllim të identifikimit të fajtorit për shkeljen e sekretit profesional dhe rrjedhimisht të burimit të informacionit përbëjnë ndërhyrje në të drejtën e tij të garantuar me nenin 10. Ajo ndërhyrje, e cila ishte e parashikuar me ligj, kishte qëllime legjitime të ndërlikdhura me parandalimin e krimit. Çështja që u shtrua para gjykatës ishte nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Kontrollimet e kryera synonin identifikimin e fajtorëve potencialë për shkeljen e sekretit profesional dhe gjetjen e veprimeve të kundërligjshme të kryera nga gazetari gjatë ushtrimit të profesionit të tij, gjë që bie në kuadër të fushëveprimit të mbrojtjes së burimeve të gazetarëve.

Kontrollimet me qëllim të identifikimit të burimeve të gazetarëve, edhe pse të padobishme, përbëjnë një veprim shumë më serioz sesa një urdhër për të zbuluar identitetin e burimeve. Kjo për arsye se zyrtarët me urdhër të tillë për kontroll duke u shfaqur pa paralajmërim dhe befasuar një gazetar në vendin e tij të punës kanë kompetenca shumë të zgjeruara që ua mundësojnë qasjen në të gjitha dokumentet e gazetarit. Artikulli i gazetarit trajtonte një çështje me interes publik. Kontrollimet ishin kryer fillimisht në vendin e punës së parashtruesit të kërkesës, ndërkohë që ndaj tij dhe disa zyrtarëve të tjerë kishin filluar edhe hetime. Përveç kontrollimeve, GjEDNj-ja vlerësoi se gjykatësi hetues ka mundur të urdhërojë masa të tjera për të identifikuar fajtorët për shkeljen e sekretit profesional. Po ashtu, qeveria kishte dështuar të bindë GjEDNj-në se sikur të mos ishin ndërmarrë kontrollimet në fjalë, autoritetet do ta kishin të pamundur të identifikonin fajtorët e veprës penale shkelje e sekretit profesional. Në këtë aspekt, Gjykata theksoi se autoritetet kanë obligim që në një shoqëri demokratike t'i balancojnë intere-



sat e përfshira në favor të lirisë së shtypit. Rrjedhimisht, argumentet e përmendura nga autoritetet për ndërhyrje në të drejtën e gazetarit për liri të shprehjes, ndonëse mund të ishin “relevante” nuk ishin të “mjaftueshme” për të arsyetuar kontrollimet dhe rrjedhimisht nuk ishin në proporcion me qëllimin e ndjekur.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)

Kontrollimi i kryer në zyrën e avokates dhe marrja e dokumentit që lidhej me dosjen e klientit të saj ishte ndërhyrje e parashikuar me ligj dhe ishte bërë për qëllim legjitim, atë të parandalimit të krimeve. Sa i përket domosdoshmërisë për të ndërmarrë ndërhyrjen dhe nëse kontrollimi i kryer në këtë rast shoqërohej me garancione procedurale të posaçme, urdhri për kontrollim u mundësonte kompetenca relativisht të gjera hetuesve. Qëllimi i kontrollimit ishte identifikimi i burimit përmes avokates, me ç’rast kontrollimi i zyrës së avokates ndikoi në të drejtën e gazetarit të mbrojtur me nenin 10 të Konventës. Duke marrë parasysh edhe faktin që urdhri për kontrollim në zyrën e avokates ishte bërë në një fazë shumë të hershme të hetimeve, ai veprim i autoriteteve nuk mund të konsiderohet se ishte proporcional me qëllimin e ndjekur.



Qëllimi i kontrollimit ishte identifikimi i burimit përmes avokates, me ç’rast kontrollimi i zyrës së avokates ndikoi në të drejtën e gazetarit të mbrojtur me nenin 10 të Konventës.

Vendimi: Shkelje e nenit 8 të Konventës (në mënyrë unanime)

3.3 Ernst dhe të tjerët kundër Belgjikës

Kërkesa nr. 33400/96, 15 tetor 2003, Dhoma e Seksionit të Dytë

Parashtruesit e kërkesës janë shtetasit belgë Martine Ernst gazetar në Radio Télévision de la Communauté Française de Belgique [RTBF], Alain Guillaume dhe René Haquin gazetarë në të përditshmen Le Soir, dhe Philippe Brewaeys gazetar në të përjavshmen Le Soir Illustré.

Më 23 qershor 1995, Njësia për Krime Serioze nën urdhrat e një gjykatësi hetues ndër-mori disa kontrollime në zyrat e gazetave, zyrën qendrore të transmetuesit publik RTBF dhe në shtëpitë e katër gazetarëve. Gjithsej tetë kontrollime ishin kryer duke përfshirë dy kontrollet e bëra në veturat e gazetarëve që kishin rezultuar me sekuestrimin e dokumenteve dhe disqeve kompjuterike të gazetarëve. Kontrollimet ishin kryer në lidhje me



3. E drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetareve

ndjekjen penale të disa anëtarëve të Shërbimit Shtetëror Ligjor të Gjykatës së Apelit në Liege për zbulim të fshehtësisë zyrtare pas rrjedhjes së dokumenteve të disa rasteve penale shumë të ndjeshme.



Qeveria nuk kishte arritur të dëshmonte se pa ushtrimin e kontrollimeve dhe të sekuestri-meve në fjalë, autoritetet nuk do të mund të dëshmonin nëse gazetarët ishin të përfshirë në veprat penale.

Më 20 shtator 1995 parashtruesit paraqitën ankesë te gjykatësi hetues në gjykatën e shkallës së parë në Bruksel kundër një apo më shumë personave të panjohur dhe kërkuan që të bashkonin rastet si palë civile. Ata ushtruan ankesë, inter alia, për mosnjohim rreth arsyeve, qëllimit dhe shtrirjes së masave të urdhëruara nga gjykatësi hetues dhe argumentuan që kontrollimet masive ndaj tyre kishin shkelur të drejtën e tyre për të mbrojtur burimet sipas nenit 10 të Konventës dhe të drejtën për respektimin e banesës dhe jetës së tyre private sipas nenit 8 të Konventës. Gjykata në Bruksel, pasi vërejti që ankesa ishte parashtruar kundër një anëtar të sistemit gjyqësor, përkatësisht gjykatësit hetues, u tërhoq nga lënda dhe e transferoi atë në Zyrën e Prokurorit Publik. Më pas, dosja e lëndës u transferua në Ministrinë e Drejtësisë dhe pastaj te kryeprokurori publik në Gjykatën e Kasacionit.

Gjykata e Kasacionit vendosi që meqë ankesa ishte drejtuar kundër një gjykatësi i cili kishte imunitet, rasti ishte i papranueshëm dhe rrjedhimisht prokuroria nuk mund të ndërmerre ndonjë veprim. Kjo gjykatë po ashtu vërejti se Kreyprokurori në Gjykatën e Apelit në Bruksel që ishte i vetmi person që kishte kompetenca të inicioje procedurë penale kundër një gjyqtari, nuk kishte ndërmarrë një gjë të tillë. Rrjedhimisht, palët u informuan që asnjë veprim i mëtutjeshëm nuk do të ndërmerrej. Në ndërkohë, më 21 nëntor 1995, parashtruesit në fjalë kishin parashtruar padi civile kundër shtetit për kompensim dëmi për shkak të humbjeve si rezultat i kontrollimeve dhe sekuestri-meve. Ajo padi ishte ende në procedurë kur gazetarët parashtruan kërkesën në GjEDNj. Parashtruesit iu drejtuan GjEDNj-së nën pretendimin se, ndër të tjera, procedura e kontrollimit dhe sekuestri-imit subjekt të së cilës kishin qenë, përbënte ndërhyrje në të drejtën për liri të shprehjes dhe respektimit të banesës dhe jetës private, të mbrojtura me nenin 8 dhe 10 të Konventës.



Parashtruesit nuk kishin qenë të akuzuar për ndonjë vepër penale dhe urdhrat ishin shkruar në mënyrë të përgjithësuar.

GjEDNj-ja vlerësoi se kontrollimet përbënin ndërhyrje në të drejtën e parashtruesve për lirinë e shprehjes, e cila ndërhyrje ishte e parashikuar me ligj. Ndërhyrja ishte bërë me qëllim të parandalimit të zbulimit të informacioneve që ishin marrë në konfidencë, të mbrojtjes së reputacionit të të tjerëve dhe në përgjithësi të ruajtjes së autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit. Në asnjë fazë të procedurave nuk ishte pretenduar se parashtruesit kishin shkruar artikuj që përmbanin informacione sekrete për rastet që kishin çuar në kryerjen e kontrolleve. Gjykata konsideroi se masat e ndërmarra me qëllim të mbledhjes së informacioneve që do të ndihmonin të gjendej e vërteta, binin në sferën e mbrojtjes së burimeve të gazetareve. Gjykata ishte e habitur me shkallën e lartë të kontrollimeve të ndërmarra të cilat ishin shtrirë në tetë operacione të njëkohshme që përfshinin rreth 160 zyrtarë policorë. Qeveria belge nuk kishte treguar se për çfarë



dyshoheshin parashtruesit në rastin kundër punëtorëve të Shërbimit Ligjor Shtetëror, të cilët besoheshin se ishin përgjegjës për rrjedhjen e informatave. Gjykata pyeti nëse do të mund të ndërmerreshin masa të tjera për të identifikuar shkeljen e besimit dhe vërejtë që qeveria nuk kishte arritur të dëshmonte se pa ushtrimin e kontrollimeve dhe të sekuestrimeve në fjalë, autoritetet nuk do të mund të dëshmonin nëse gazetarët ishin të përfshirë në veprat penale. Për më tepër, hetuesit - roli i të cilëve ishte të zbulonin burimet e informacioneve të gazetarëve - kishin kompetenca shumë të gjera hetuese dhe kishin ndërmarrë kontrollime në shtëpitë dhe vendet e punës së gazetarëve. Në këto rrethana, Gjykata gjeti që qeveria belge nuk ka dëshmuar se ka balancuar drejt të gjitha interesat e përfshira. Edhe pse arsyet për ndërhyrje konsideroheshin si relevante, ato nuk ishin aq të mjaftueshme sa të arsyetonin shkallën aq të lartë të kontrollimeve dhe sekuestrimeve. Kur merret parasysh interesi i shoqërive demokratike në sigurimin dhe ruajtjen e lirisë së shtypit, atëherë masat e përdorura në këtë rast nuk ishin në proporcion me qëllimin e ndjekur.



Urdhri nuk ofronte informata për hetimin në fjalë, vendet që duhej të kontrolloheshin, apo objektet që duhej të sekuestroheshin.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)

Lidhur me nenin 8, kontrollimet në shtëpitë, vendet e punës dhe në disa vetura, përbënin ndërhyrje në të drejtën e respektimit të banesës së tyre. Kjo ndërhyrje kishte bazë ligjore dhe ishte legjitime, pasi që ishte bërë me qëllim të mbrojtjes dhe lirisë së tjerëve. Kontrollimet ishin shoqëruar me disa masa procedurale mbrojtëse. Sidoqoftë, parashtruesit nuk kishin qenë të akuzuar për ndonjë vepër penale dhe urdhrat ishin shkruar në mënyrë të përgjithësuar. Qëllimi i urdhrave për kontrollim ishte thënë se ishte kontrollimi dhe sekuestrimi i “çdo dokumenti apo objekti që mund të ndihmonte në hetime”, pa ndonjë kufizim. Për më tepër, urdhri nuk ofronte informata për hetimin në fjalë, vendet që duhej të kontrolloheshin, apo objektet që duhej të sekuestroheshin. Qeveria e kishte pranuar faktin që parashtruesit nuk ishin njoftuar fare për arsyet e kontrollimit. Në këto rrethana, Gjykata gjeti që kontrollimet e bëra nuk ishin në proporcion me qëllimin e ndjekur.

Vendimi: Shkelje e nenit 8 të Konventës (në mënyrë unanime)

3.4 Voskuil kundër Holandës

Kërkesa nr. 64752/01, 22 shkurt 2008, Dhoma e Seksionit të Tretë

Parashtruesi i kërkesës, Koen Voskuil, i lindur më 1975 është shtetas holandez dhe banon në Amsterdam. Në atë kohë ai punonte gazetar në Gazetën Spit!s. Rasti ka të bëjë më pretendimin se atij i është mohuar e drejta e mbrojtjes së burimeve për dy shkrime



3. E drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetareve

të botuara në Gazetën Spits, meqë ishte ndaluar në polici për më shumë se dy javë në tentativë për ta detyruar atë që të zbulonte burimet.

Pas një hetimi penal gjatë të cilit ishte gjetur një arsenal i armëve në një banesë në Amsterdam, tre persona K, Van S dhe H, ishin dënuar për trafikim të armëve. Më 12 dhe 13 shtator 2000 gazeta botoi dy shkrime nga gazetari në fjalë dhe një koleg i tij që shprehnin dyshime nëse kishte qenë rastësi që policia e Amsterdimit kishte gjetur armë në atë banesë, meqenëse fillimisht ata ishin thirrur aty për të kontrolluar një rrjedhje uji. Njëri shkrim kishte cituar një polic të Amsterdimit i cili i referohej rrjedhes së kësaj informate si “zbulim i madh” për hetime.



Gjykata ishte habitur me të gjitha masat që autoritetet holandeze kishin ndërmarrë me qëllim që të zbulonin burimin e informacionit të gazetarit. Këto masa mund të dekurajojnë të flasin dhe të ndajnë me shtypin ata që kanë informata të vërteta dhe të sakta lidhur me parregullsi.

Pas botimit të shkrimit, gazetari ishte ftuar nga ana e mbrojtjes të paraqitej si dëshmitar gjatë seancave gjyqësore në rastin e akuzimit të tre personave për armëmbajtje pa leje.

Në seancën e parë gazetari deklaroi se e dinte që polici i cituar në shkrim kishte qenë i përfshirë në hetime të mëhershme ndaj personit K. Kur u pyet nëse polici ishte i përfshirë ose në dijeni të hetimeve në banesën në fjalë, gazetari shfrytëzoi të drejtën e tij për të ruajtur burimin. Gjykata vendore konsideroi që nëse deklarata e bërë nga polici ishte e saktë, atëherë integriteti i policisë dhe gjyqësisë do të vihej në pikëpyetje. Pasi iu kujtua që ai mund të ndalohej nëse nuk i bindej gjykatës, gazetari pranoi që burimi i tij kishte qenë në dijeni dhe i përfshirë në hetimin që kishte ndodhur në banesën në fjalë. Gjykata e urdhëroi gazetarin që të zbulonte identitetin e burimit në interes të personave të akuzuar dhe të integritetit të policisë dhe autoriteteve gjyqësore. Gazetari shfrytëzoi të drejtën e heshtjes dhe me atë rast gjykata urdhëroi ndalimin e tij të menjëhershëm. Pas seancës gjyqësore, një hetim i brendshëm policor ishte ndërmarrë dhe tetë policët që kishin qenë të përfshirë kishin dhënë deklarata nën betim që asnjëherë nuk kishin qenë në kontakt me gazetarin. Gazetari insistonte që nuk dëshironte të zbulonte identitetin e burimit të tij. Ai kishte deklaruar se sikur të fillonte të zbulonte burimet e tij, do të ishte njëjtë sikur të përfundonte karrierën, pasi që burimet nuk do t'i ofronin më informata. Pas më shumë se dy javësh gjykata e shpalli të pavlefshëm urdhërin për mbajtjen e gazetarit dhe ai u lirua. Duke u bazuar në nenin 10, gazetari paditi shtetin e Holandës nën pretendimin se mbajtja për ta detyruar që ta zbulonte burimin kishtë cenuar të drejtën e tij për liri të shprehjes.

GjEDNJ-ja fillimisht vlerësoi se kishte ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes së parashtruesit, pasi që refuzimi i tij për të zbuluar burimin kishte çuar në mbajtjen e tij. Ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj për mbrojtjen e qëllimit legjitim të parandalimit të krimin. Gjykata rikujtoi se mbrojtja e burimeve është një ndër kriteret themelore për lirinë e shtypit dhe pa këtë mbrojtje burimet mund të dekurajohen që të ndihmojnë mediat në informimin e publikut për çështje me interes publik dhe kështu roli mbikëqyrës i mediave do të nënvlerësohej. Urdhri për zbulimin e burimit mund të arsyetohet vetëm nëse ekziston një kërkesë që mbizotëron interesin publik në ruajtjen e burimeve.



GjEDNj-ja i mori parasysh arsyet sipas të cilave iu kërkua parashtruesit të identifikonte burimin: për të siguruar gjykim të drejtë për personat e akuzuar për trafikim armësh dhe për të mbrojtur integritetin e policisë së Amsterdemit. Sipas Gjykatës, arsyeja e parë nuk ishte relevante. Çfarëdo domethënie të ketë pasur ajo informatë për gjykimin e personave, nuk kishte ndikuar në rastin konkret, sepse informatat e gazetarit ishin mbështetur nga dëshmitarët tjerë. Sa i përket arsyes së dytë, Gjykata nuk ka mundur të vërtetojë nëse ka pasur ndonjë të vërtetë në shkrimet e gazetarit. Sidoqoftë, vlerësoi se në një shtet demokratik ku mbizotëron sundimi i ligjit, përdorimi i metodave joadekuate gjatë punës së tyre nga autoritetet publike është pikërisht tema për të cilën publiku ka të drejtë të jetë i informuar. Gjykata ishte habitur me të gjitha masat që autoritetet holandeze kishin ndërmarrë me qëllim që të zbulonin burimin e informacionit të gazetarit. Këto masa mund të dekurajojnë të flasin dhe të ndajnë me shtypin ata që kanë informata të vërteta dhe të sakta lidhur me parregullsi. Gjykata konkludoi që interesi i qeverisë për të ditur identitetin e burimit të informacionit nuk ka qenë i mjaftueshëm sa ta mbizotërojë interesin e gazetarit që ta ruajë atë dhe rrjedhimisht ka pasur shkelje të nenit 10.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)

3.5 Tillack kundër Belgjikës

Kërkesa nr. 20477/05, 27 shkurt 2008, Dhoma e Seksionit të Dytë

Parashtruesi i kërkesës, Hans Martin Tillack, është shtetas gjerman i lindur më 1961 dhe banues në Berlin. Në atë kohë ai ishte gazetar në magazinën javore Stern dhe ishte caktuar korrespondent në Bruksel nga muaji gusht 1999 deri në korrik 2004 që të raportonte për politikën e Bashkimit Europian dhe aktivitetet e institucioneve europiane.

Më 27 shkurt dhe 7 mars 2002 Stern botoi dy artikuj të shkruar nga Tillack bazuar në dokumente konfidenciale nga Zyra Europiane Kundër Mashtrimit [European Anti Fraud Office – OLAF]. Artikulli i parë raportonte për pretendimet e një shërbyesi civil lidhur me parregullsi në institucionet europiane, ndërsa i dyti trajtonte hetimet e brendshme që OLAF-i kishte ndërmarrë lidhur me këto pretendime. Nën dyshimin se gazetari kishte korruptuar një shërbyes civil për informata konfidenciale rreth progresit të hetimeve në fjalë duke i paguar në shkëmbim 8,000 euro, OLAF-i paraqiti kallëzim penal dhe institucionet përgjegjëse filluan hetime kundër një apo më shumë personave për shkelje të sekretit profesional dhe marrje rryshfeti. Më 19 mars 2004 shtëpia dhe vendi i punës së gazetarit ishin kontrolluar dhe gati të gjitha dokumentet dhe mjetet e punës së tij ishin sekuestruar. Parashtruesi i kërkesës kërkoi që t'i ktheheshin gjërat e tij, por nuk pati sukses. Ndërkohë, ai ushtroi ankesë pranë Zyrës së Ombudsmanit Europian. Kjo



3. E drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetarëve

zyrë i dërgoi një raport special Parlamentit Europian me konkludimin se dyshimet për korruptimin e shërbyesit civil ishin të bazuara vetëm në thashetheme që ishin përhapur nga një gazetar tjetër dhe jo nga deputetët e Parlamentit Europian ashtu siç pretendonte OLAF-i. Ombudsmani rekomandonte që OLAF-i duhet të pranonte se kishte bërë deklaratatë të pasakta.



E drejta e gazetarëve për të mbrojtur burimet nuk duhet të konsiderohet si privilegj që mund t'u jepet apo merret atyre varësisht nga veprimet e ligjshme apo të kundërligjshme të burimeve të tyre, por është aspekt i së drejtës që shkon bashkë me të drejtën për informacion.

Parashtruesi u ankua në GjEDNj, në veçanti, nën pretendimin se kontrollimi dhe sekuestrimi në shtëpinë dhe vendin e tij të punës përbënte shkelje të së drejtës për liri të shprehjes të garantuar me nenin 10. GjEDNj-ja ritheksoi se shtypi luan rol thelbësor në një shoqëri demokratike dhe se mbrojtja e burimeve të gazetarëve është kriter bazik për lirinë e shtypit. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideroi se kontrollimi në fjalë përbënte ndërhyrje në të drejtën e tij për liri të shprehjes. Ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe ndiqte qëllimin legjitim të parandalimit të krimit, të parandalimit të zbulimit të informacionit të marrë në konfidencë dhe mbrojtjes së reputacionit të tjerëve.

Sa i përket çështjes nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, Gjykata vërejti që ndër të tjera në kohën kur ishte bërë kontrollimi, qëllimi i tij kishte qenë identifikimi i burimit të informacionit për të cilin parashtruesi kishte shkruar në artikujt e tij. Këto masa kishin të bënin me mbrojtjen e burimeve. Duke qenë kështu, GjEDNj-ja theksoi se e drejta e gazetarëve për të mbrojtur burimet nuk duhet të konsiderohet si privilegj që mund t'u jepet apo merret atyre varësisht nga veprimet e ligjshme apo të kundërligjshme të burimeve të tyre, por është aspekt i së drejtës që shkon bashkë me të drejtën për informacion. Në rastin konkret, ky parim vlente edhe më shumë, pasi që ai dyshohej bazuar në thashetheme të paqarta siç ishte dëshmuar me faktin që gazetari asnjëherë nuk ishte akuzuar zyrtarisht. Për më tepër, policia kishte sekuestruar një sasi shumë të madhe të materialeve, nuk i kishte evidentuar ato dhe kishte humbur disa nga dokumentet të cilat ishin gjetur vetëm pas shtatë muajsh. Rrjedhimisht, gjykata konsideroi se edhe pse arsyet e dhëna nga gjykatat belge ishin të nevojshme, ato nuk mund të quheshin të mjaftueshme aq sa të justifikonin kontrollimet e bëra.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)



3.6 Financial Times dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar

Kërkesa nr. 821/03, 15 mars 2010, Dhoma e Seksionit të Katërt

Rasti ka të bëjë me katër gazeta britanike dhe një agjenci lajmesh - Financial Times, Independent News & Media Ltd, Guardian Newspapers Ltd, Times Newspapers Ltd dhe Reuters Group plc – të cilat ishin urdhëruar nga gjykatat vendore të dorëzonin një dokument që mund të çonte në identifikimin e një prej burimeve të tyre.

Më 2001, gazetari i Financial Times pranoi një dokument të rrjedhur nga një burim i mbrojtur që tregonte për mundësinë që kompania belge Interbrew të blejë kompaninë South African Breweries plc (SAB). Gazetari i kishte telefonuar kompanisë për ta informuar për dokumentin që e posedonte dhe se planifikonte ta publikonte. Një shkrim i publikuar në portalin e njëres prej gazetave, duke iu referuar materialit të rrjedhur, thoshte se kompania ishte përfshirë në një komplot me qëllim që ta blente kompaninë tjetër. Në ditët në vijim, gazetat tjera – parashtruese në këtë rast - kishin botuar shkrime që po ashtu i referoheshin së njëjtës temë. Pas një komunikate për media të kompanisë Interbrew, mediat në fjalë vazhduan të raportonin, duke theksuar që dokumenti mund të ishte i fabrikuar.

Shkrimet e botuara patën ndikim domethënës në aksionet e të dyja kompanive. Sigurimi i Interbrew dhe këshilltarët e riskut dështuan disa herë të identifikonin burimin e informacionit. Interbrew kërkoi me sukses nga gjykata që dokumenti i rrjedhur të zbulohet me qëllim që të identifikohet burimi. Sipas gjykatave vendore, burimi qëllimisht kishte rrjedhur një ‘shpifje vdekjeprurëse’ me pasoja të rënda për integritetin e tregut dhe se dokumenti duhej të zbulohet sepse ishte në interes të drejtësisë për të parandaluar një vepër penale. Mediumet nuk e zbuluan burimin dhe iu drejtuan GjEDNj-së nën pretendimin që kërkesa për zbulimin e burimit ishte në kundërshtim me nenin 10 të Konventës.

GjEDNj-ja vlerësoi se edhe pse urdhri për zbulim të burimeve nuk u ekzekutua, ai përsëri përbënte ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes së parashtruesve. Ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve dhe parandalimin e zbulimit të informacioneve të marra në konfidencë. Lidhur me çështjen nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, Gjykata vlerësoi



GjEDNj-ja vlerësoi se edhe pse urdhri për zbulim të burimeve nuk u ekzekutua, ai përsëri përbënte ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes së parashtruesve.



3. E drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetareve

se urdhri për zbulimin e burimit kishte ndikim të dëmshëm jo vetëm në burimin e informacionit, por edhe te vetë gazetatat. Kjo sepse reputacioni i mediave në fjalë nëse do të zbulohet burimi ka mundur të dëmtohet në sytë e burimeve potenciale në të ardhmen dhe të vetë publikut, i cili ka të drejtë të pranojë informata përmes burimeve anonime.



Gjykatat vendore në mungesë të fakteve nuk duhet të supozojnë që një burim ka vepruar në keqbesim.

Lidhur më çështjen nëse veprimet e burimit kanë mundur të tejkalojnë parimin e ruajtjes së burimeve, GjEDNj-ja shpjegoi se gjykatat vendore në mungesë të fakteve nuk duhet të supozojnë që një burim ka vepruar në keqbesim. Sidoqoftë, duke marrë parasysh se në këtë rast ishin të përfshira shumë interesa, veprimet e burimit nuk mund të jenë asnjëherë faktor vendimtar gjatë vlerësimit nëse një urdhër zbulimi është dashur të lëshohet, ndonëse ky faktor është me rëndësi në balancimin e të drejtave të përfshira. Gjatë vlerësimit të balancimit të të drejtave të përfshira, Gjykata u fokusua në këto aspekte: qëllimi i rrjedhjes së informacionit, autenciteti i dokumentit të rrjedhur dhe interesi i Interbrew në identifikimin e burimit, sjellja para drejtësisë e burimit dhe efekti i urdhrin për zbulimin e burimit.



Veprimet e burimit nuk mund të jenë asnjëherë faktor vendimtar gjatë vlerësimit nëse një urdhër zbulimi është dashur të lëshohet.

Sa i përket aspektit të parë, gjykata vendore e kishte përshkruar qëllimin e burimit si “të keq dhe të kalkuluar për qëllim fitimi ose mërie....” Sidoqoftë, edhe pse GjEDNj-ja pranoi që mund të ketë rrethana kur qëllimi dëmtues i burimit do të arsyetonte zbulimin e identitetit të tij, në rastin konkret gjatë shqyrtimeve gjyqësore kundër parashtruesve të kërkesës nuk është arritur të kuptohet qëllimi i burimit. Aspekti i dytë – autenciteti i dokumentit të rrjedhur, nuk duket të jetë domethënës, pasi që gjykatat vendore nuk kishin arritur të vërtetonin nëse dokumenti ishte fabrikuar dhe çështja se çfarë veprime ka ndërmarrë gazetari për të vërtetuar saktësinë e dokumentit nuk mund ketë qenë faktor vendimtar, por është dashur të vlerësohet në kontekst të rastit në tërësi. Lidhur me interesin e kompanisë Interbrew që të identifikonte burimin, Gjykata vërejtë që qëllimi ishte parandalimi i rrjedhjeve të ardhshme dhe ushtrimi i padisë për kompensim dëmi kundër burimit. Edhe pse ishte paralajmëruar publikimi i lajmit, kompania nuk kishte paraqitur kërkesë për masë të përkohshme për të ndaluar publikimin e lajmit. Qëllimi i parandalimit të rrjedhjeve të ardhshme do të justifikonte një urdhër për zbulimin e burimit, vetëm nëse asnjë masë tjetër alternative nuk e mundësonte në gjë të tillë dhe nëse rrjedhja e dokumenteve do të përbënte rrezik serioz. Së fundi, sa i përket efektit të zbulimit të burimit, gjykata vlerësoi se nuk mund të bëhet dallim në mes të zbulimit të drejtëpërdrejtë të identitetit të burimit dhe atij që do të çonte në zbulimin e burimit [përmes dokumenteve], sepse efekti frenues [chilling effect] mund të krijohet sa herë që gazetaret shihen duke ndihmuar në cilëndo mënyrë në zbulimin e burimeve anonime. Prandaj kishte mjaftuar fakti që ishte kërkuar informacion apo ndihmë për të identifikuar burimin. Rrjedhimisht, interesi për të eliminuar dëmin nga publikimet e ardhshme dhe për të kërkuar kompensim dëmi për shkelje të ruajtjes së konfidencialitetit nuk e tejkalon interesin e publikut në mbrojtjen e burimeve të gazetareve.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)



3.7 Sanoma Uitgevers kundër Holandës

Kërkesa nr. 38224/03, 14 shtator 2010, Dhoma e Madhe

Parashtruesi Sanoma Uitgevers është kompani e vendosur në Hoofddorp në Holandë që merret me publikimin dhe promovimin e magazinave, duke përfshirë botimin e së përjavshmes Autoweek që u dedikohet lexuesve të interesuar për sporte automobilistike.

Autoweek vendosi të publikonte një shkrim rreth garave ilegale me vetura në rrugë. Gazetarët morën leje nga organizuesit e një prej këtyre garave që të bënin fotografi, me kusht që të mos zbulonin identitetin e pjesëmarrësve në garë. Gjatë ngjarjes, gara u ndalua nga policia, por nuk rezultoi me ndonjë arrest. Fotografitë origjinale ishin ruajtur në një CD-ROM [në një zyrë të një gazete tjetër të cilën po ashtu e botonte e njëjta kompani] dhe ideja e gazetarëve ishte që ato të redakttoheshin para se të botoheshin për të pamundësuar identifikimin e veturave dhe për të ruajtur identitetin e pjesëmarrësve. Para se të botohej shkrimi, një prokuror publik kishte kërkuar nga kryeredaktori që t'ia dorëzonte fotografitë e paredaktuara nën arsyetimin se kërkoheshin për hetime penale që përfshinin rrezikshmëri të natyrës “jetë a vdekje.” Pas refuzimit, kryeredaktori ishte kërcënuar që do të mbahej në polici dhe që zyrat e kompanisë do të kontrolltoheshin dhe do të sekuestroheshin kompjuterët. Si rezultat, kompania mund të mbyllej përkohësisht dhe kjo do të rezultonte me humbje të mëdha financiare. Po ashtu, kryeredaktori ishte ndaluar për disa orë brenda zyrave të kompanisë. Përfundimisht fotografitë ishin dorëzuar, pasi që një gjykatës hetues, opinionin e të cilit e kishte kërkuar mediumi në fjalë, shprehu qëndrimin se nevoja për të kryer hetimet tejkalonte interesin e gazetarëve për të mbrojtur burimet.

Sekuestrimi i kontestuar nga kompania ishte gjykuar si e ligjshëm nga një gjykatë regjionale pas dëshmisë së prokurorit që fotografitë kërkoheshin për të identifikuar një veturë që ishte përdorur në një vepër penale që përfshinte bankomatët dhe jo garat rru-gore. Aktgjykimi ishte konfirmuar edhe nga gjykata e apelit. Kompania paraqiti kërkesë para GjEDNj-së nën pretendimin se detyrimi për të zbuluar informata që do të çonin në zbulimin e burimit përbën cenim të së drejtës për të marrë dhe për të dhënë informacione, siç garantohet me nenin 10 të Konventës. Autoritetet kishin deklaruar se zyrat e parashtrueses së kërkesës do të kontrolltoheshin nëse nuk do të dorëzohej CD-ROM-i që nënkuptonte mbylljen e përkohshme të zyrës, humbje financiare dhe vonesë në botimin e lajmeve. Një nga gazetarët ishte ndaluar përkohësisht.



GjEDNj-ja pranoi se baza ligjore ekzistonte, por vërejti se në mënyrë që të përmbushej “cilësia” e kërkesës ligjore, çdo ndërhyrje në të drejtën e mbrojtjes së burimeve dhe të informacioneve që mund të çojë në zbulimin e identitetit, duhet të përmbajë masa mbrojtëse procedurale.



3. E drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetareve



Gjykata vërejtë se që nga hyrja në fuqi e Kodit të Procedurës Penale të Holandës, kompetenca për të urdhëruar zbulimin e burimeve i ishte besuar prokurorit publik në vend se t'i besohej një gjykatësi të pavarur.

Sipas GjEDNj-së, edhe pse kontrollimi në fjalë nuk ishte realizuar asnjëherë, rasti kishte të bënte me një urdhër për dorëzim të detyrueshëm të materialeve të mediumit që mund të zbulonin burimet e gazetareve. Ai urdhër në vetvete përbënte ndërhyrje në të drejtën e kompanisë që të marrë dhe të japë informacione, të garantuar me nenin 10. Sa i përket çështjes nëse ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj, GjEDNj-ja pranoi se baza ligjore ekzistonte, por vërejtë se në mënyrë që të përmbushej “cilësia” e kërkesës ligjore, çdo ndërhyrje në të drejtën e mbrojtjes së burimeve dhe të informacioneve që mund të çojë në zbulimin e identitetit, duhet të përmbajë masa mbrojtëse procedurale. Këto masa përfshijnë garancionin e rishikimit nga një organ me fuqi ligjore që është i pavarur dhe i paanshëm për të vendosur nëse ekzistonte interes publik më i madh se ai për mbrojtjen e burimeve. Një rishikim i tillë, me efekt parandalues, do të balanconte rreziqet potenciale dhe interesat e përfshira, para se të bëhej zbulimi i identitetit të ndonjë burimi. Ndërmarrja e rishikimit *ex post facto* do të nënvlerësonte thelbin e së drejtës së konfidencialitetit. Vendimi i organit rishikues duhet të përmbajë kritere të qarta, duke përfshirë vlerësimin nëse masa më pak ndërhyrëse do ishin të mjaftueshme. Njëkohësisht, organi rishikues duhet të ketë kompetencë që të refuzojë zbulimin, ose të japë urdhër për të mbrojtur burimet e gazetareve në raste specifike.

Duke i zbatuar këto parime në rastin e kompanisë në fjalë, Gjykata vërejtë se që nga hyrja në fuqi e Kodit të Procedurës Penale të Holandës, kompetenca për të urdhëruar zbulimin e burimeve i ishte besuar prokurorit publik në vend se t'i besohej një gjykatësi të pavarur. Edhe pse prokurori zotohet të ushtrojë detyrën me integritet, nga pikëpamja procedurale ai është “palë” që mbron interesa të cilat nuk përputhen me mbrojtjen e burimeve të gazetareve dhe rrjedhimisht nuk mund të konsiderohet objektiv dhe i paanshëm. Tutje, edhe pse kompanisë i ishte lejuar përfshirja e gjykatësit hetues në këtë rast, intervenimi i tij nuk kishte pasur bazë ligjore dhe ai kishte luajtur vetëm rol këshillues, pa ndonjë kompetencë ligjore. Rrjedhimisht, tërë situata e krijuar vështirë se mund të konsiderohej në harmoni me sundimin e ligjit. Këto dështime nuk ishin përmirësuar me rishikimin *ex post facto* nga gjykata regjionale, e cila ishte e pafuqishme të ndalonte prokurorin publik dhe policinë që të ekzaminonin fotografitë e ruajtura në CD-ROM-in e sekuestruar. Si përfundim, ligji në fjalë nuk është mjaftueshëm cilësor për shkak se nuk parashihte masat mbrojtëse të përmendura më lart dhe rrjedhimisht Gjykata konkludoi se ndërhyrja nuk ishte e parashikuar me ligj.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)



3.8 Ressiots dhe të tjerët kundër Francës

Kërkesat nr. 15054/07 dhe 15066/07, 28 shtator 2012, Dhoma e Pestë e Seksionit

Parashtruesit e kërkesës, Ressiots, Issartel, Labbé, Decugis and Recasens janë shtetas francezë të lindur më 1964, 1967, 1967, 1963 dhe 1970. Ata janë gazetarë që në atë kohë punonin në gazetën ditore sportive L'Equipe dhe magazinën javore Le Point.

Më 2004 kishte filluar një hetim rreth pretendimeve për doping kundër anëtarëve të ekipit të çiklistëve Cofidis. Më 22 janar 2004 Le Point kishte botuar një artikull të nënshkruar nga Labbé, Decugis dhe Recasens që prezentonte pasazhe të tëra të transkripteve të përgjimeve telefonike të bëra gjatë hetimeve nga njësia kundër drogës [policia]. Më 29 janar, e njëjta gazetë botoi një artikull të ri të nënshkruar nga të njëjtit gazetarë që listonte substancat e kundërligjshme të sekuestruara gjatë një kontrollimi në shtëpinë e një ish-çiklisti. Inspektorati Kombëtar Policor inicioi hetime për të zbuluar personat përgjegjës për rrjedhjet e informacionit. Më 4 shkurt 2004 një prokuror i kërkoi këtij inspektorati të hetojë të njëjtën çështje. Më 8 prill 2004 ekipi i çiklistëve Cofidis parashtrroi kërkesë të pasuksesshme për masë të përkohshme ndaj një shkrimi që do të botohej ditën e nesërme në L'Equipe, nën pretendimet se përmbante fyerje, shkelte parimin e prezumimit të pafajësisë dhe konfidencialitetin e hetimeve. L'Equipe vazhdoi të botonte shkrime me citate të transkripteve zyrtare dhe dokumenteve procedurale edhe më 9 dhe 10 prill. Më 15 prill ekipi i çiklistëve Cofidis ushtroi kallëzim penal dhe padi civile për kompensim dëmi ndaj një apo më shumë personave të panjohur për shkelje të fshehtësisë zyrtare dhe përdorim të materialit të marrë si rezultat i saj. Hetimi i Inspektoratit Kombëtar Policor iu bashkëngjiti dosjes së rastit dhe 12 zyrtarë policorë, tre gazetarë dhe drejtori i Le Point u morën në pyetje. Më 10 janar prokurori publik kishte urdhëruar kontrollimin e zyrave të L'Equipe dhe Le Point duke shpresuar se do të gjente gjurmë të dokumenteve të rrjedhura. Të gjithë gazetarët parashtruan kërkesë që provat e mbledhura gjatë kontrollimit të zyrave të tyre dhe përgjimi i telefonatave të tyre të shpallehin të papranueshme.



Ndonëse gjykata e njeholin rolin vital që shtypi ka në një shoqëri demokratike, gazetarët nuk mund të parim të lirohen nga obligimet e tyre që të veprojnë në harmoni me legjislacionin penal.

Më 26 maj Gjykata e Apelit në Versailles vendosi që publikimi i informacioneve konfidenciale kishte komprometuar hetimet dhe përbënte shkelje të prezumimit të pafajësisë së personave të përmendur në shkrime dhe shkelje të privatësisë së tyre përmes publikimit të transkripteve të përgjimeve të telefonatave. Sa i përket ankesës së gazetarëve, gjykata vendosi të mos pranojë si provë përgjimet e bëra ndaj gazetarëve, por gjeti se kontrollimi dhe sekuestrimi i disa materialeve të gazetarëve ishte veprim legjitim, i



3. E drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetarëve

nevojshëm dhe proporcional me qëllimin e ndjekur dhe me nevojën e gazetarëve për të mbrojtur burimet e tyre. Pas disa ankesave dhe proceseve gjyqësore të gjithë gazetarët e përfshirë ishin liruar nga akuzat.



Kontrollimi dhe përgjimi i telefonatave të gazetarëve dhe kontrollimi në shtëpitë dhe zyrat e mediumeve në fjalë ishin autorizuar pa ndonjë provë që dëshmonte nevojën shoqërore urgjente.

Gazetarët Issartel, Labbé, Decugis and Recasens parashtruan kërkesë në GjEDNJ nën pretendimin se hetimi ndaj tyre përbënte shkelje të nenit 10 të Konventës. GjEDNJ-ja ritheksoi se mbrojtja e burimeve të gazetarëve është një ndër themelet e lirisë së shprehjes. Pa këtë mbrojtje, burimet mund të dekurajohen në asistimin e informimit të publikut. Si rezultat, roli vital i shtypit prej mbikëqyrësi mund të nënvlerësohet ashtu si edhe mundësia e tij që të ofrojë informata të sakta dhe të besueshme. Gjykata iu referua edhe Rekomandimit Rec (2003)13 të Këshillit të Ministrave për raportimin e çështjeve penale nga mediat, duke theksuar rëndësinë e mediave në informimin e rasteve penale dhe mbikëqyrjes së funksionimit të sistemit gjyqësor. Ndërrhyrja në konfidencialitetin e burimeve të gazetarëve mund të arsyetohet vetëm nëse ekzistojnë argumente që tejkalojnë interesin publik. Në rastin konkret, Gjykata vlerësoi se ndërhyrja nga autoritetet për shkak të konfidencialitetit të hetimeve kishte për qëllim parandalimin e zbulimit të informacioneve konfidenciale, mbrojtjen e reputacionit të të tjerëve, sigurimin e zhvillimit adekuat të procedurës hetimore dhe rrjedhimisht mbrojtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit. Gazetarët dyshoheshin se kishin përdorur informata të marra kundërligjshëm nga një hetim penal. Tema e artikujve – dopingu në sportin profesional, në këtë rast në çiklizëm përbënte çështje në interes të publikut. Ndonëse gjykata e njeh rolin vital që shtypi ka në një shoqëri demokratike, gazetarët nuk mund në parim të lirohen nga obligimet e tyre që të veprojnë në harmoni me legjislacionin penal. Gjykata vërejti që autoritetet kishin ndërmarrë veprimet kundër gazetarëve relativisht vonë, në shtator 2004 dhe janar 2005, përdërisa shkrimet ishin botuar në janar dhe prill 2004. Rrjedhimisht, qëllimi i vetëm i kontrollimeve dhe përgjimit të telefonatave ishte identifikimi i burimit të informacionit të botuar në gazetë. Përpjekjet e mëhershme të hetuesve për të gjetur rrjedhësin e informatës kishin dështuar. Gjykata konsideroi se kjo çështje qartësisht bie në sferën e mbrojtjes së burimeve të gazetarëve. GjEDNJ-ja theksoi se e drejta e gazetarëve për të mbrojtur burimet nuk duhet të konsiderohet si privilegj që mund t'u jepet apo merret atyre varësisht nga veprimet e ligjshme apo të kundërligjshme të burimeve të tyre, por është aspekt i së drejtës që shkon bashkë me të drejtën për informacion. Kontrollimi dhe përgjimi i telefonatave të gazetarëve dhe kontrollimi në shtëpitë dhe zyrat e mediumeve në fjalë ishin autorizuar pa ndonjë provë që dëshmonte nevojën shoqërore urgjente. Qeveria nuk kishte dëshmuar që ishin balancuar drejt të gjitha interesat e përfshira. Edhe sikur arsyet e dhëna të ishin relevante, sipas Gjykatës ato nuk ishin të mjaftueshme për të arsyetuar kontrollimin dhe sekuestrimin e bërë. Masat e përdorura nuk ishin proporcionale me qëllimin e ndjekur, duke marrë parasysh interesin e një shoqërie demokratike për të siguruar dhe ruajtur lirinë e shprehjes. Kështu pra, është bërë shkelje e nenit 10 të Konventës.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)



3.9 Martin dhe të tjerët kundër Francës

Kërkesa nr. 30002/08, 12 korrik 2012, Dhoma e Seksionit të Pestë

Parashtruesit Francois Martin, Jacky Vilaceque, Anthony Jones dhe Pierre Bruynooghe, janë shtetas francezë të lindur më 1955, 1949, 1955 dhe 1961 dhe jetojnë në Poulx Assas, Poussan dhe Montpellier. Në atë kohë të gjithë ishin gazetarë në të përditshmen Midi Libre.

Më 31 gusht 2005 Zyra Regjionale e Auditorit në Languedoc-Roussillon kishte draftuar një raport që kritikonte menaxhmentin e këtij regjioni gjatë kohës sa J.B, anëtar i Senatit të Francës që nga viti 2011 ishte kryetar i Këshillit Regjional. E përditshmja Midi Libre publikoi disa artikuj me citate të raportit, ndonëse raporti ishte dokument konfidencial. Më 3 nëntor 2005 J.N inicioi rast për zbulim të informacionit konfidencial. Për të zbuluar se në çfarë rrethana gazetarët i kishin marrë në posedim dokumentet konfidenciale, gjykatësi hetues i ndihmuar nga një ekspert kompjuteri, vendosi të urdhërojë kontrollimin e zyrave të gazetës Midi Libre. Kontrollimi u bë më 5 korrik 2006 me ç'rast u sekuestruan disa dokumente, duke përfshirë një kopje të raportit të zyrës së auditorit. Gjykatësi po ashtu konfiskoi kopje të disqeve të kompjuterëve të gazetarëve në fjalë. Analizat e disqeve të kompjuterëve zbuluan gjurmë të raportit në fjalë në dy kompjuterë të gazetarëve, mirëpo hetimi nuk mundi të zbulonte se kush ua kishte dhënë apo dërguar raportin konfidencial gazetarëve.

Pas këtij hetimi, gjykatësi filloi hetimet kundër katër gazetarëve për përdorim të dokumenteve që ishin zbuluar si pasojë e shkeljes së fshehtësisë zyrtare. Gjatë marrjes në pyetje, ata shfrytëzuan të drejtën e tyre si gazetarë që të mbrojnë burimet. Më vonë ata kërkuan që materialet e mbledhura si rezultat i kontrollimit dhe sekuestrimit të mos pranohen dhe procedura të pushohet sepse ishte në kundërshtim me nenin 10 të Konventës. Gjykata e apelit e hodhi poshtë pretendimin e gazetarëve duke vlerësuar se kontrollimi ishte bërë për të kuptuar se si kanë mundur gazetarët të marrin raportin konfidencial. Kjo gjykatë shtoi se mbrojtja e burimeve të gazetarëve nuk mund të pengojë hetimin e së vërtetës në raste penale. Edhe gjykata e kasacionit hudhi poshtë ankesën e tyre. Më 4 tetor 2007 Gjykata e Apelit të Montpellier konfirmoi se meqë nuk ishte vërtetuar zbulimi i informacionit konfidencial, atëherë nuk mund të ketë vepër penale që rrjedh nga përdorimi atij informacioni.

Gazetarët parashtruan kërkesë në GjEDNj nën pretendimin se hetimi ndaj tyre përbën shkelje të të drejtës së lirisë së shprehjes të garantuar me nenin 10 të Konventës. GjEDNj-ja



3. E drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetareve

ritheksoi se kontrollimi në shtëpitë dhe vendet e punës së gazetareve me qëllim të identifikimit të burimeve që kanë shkelur fshehtësinë zyrtare shkel të drejtën e lirisë së shprehjes.



Roli i gazetareve hulamtues është pikërisht informimi dhe alarmimi i publikut, sidomos me lajme të këqija, menjëherë posa ata t'i marrin ato informacione.

Në rastin konkret, gjykata vlerësoi se ka pasur ndërhyrje në të drejtën e gazetareve për të marrë dhe dhënë informacione. Ndërhyrja ishte e papraparë me ligj dhe ishte legjitime, pasi që synonte të parandalonte publikimin e informacionit konfidencial dhe të mbronte të drejtat e të tjerëve, në veçanti të drejtën e prezumimit të pafajësisë. Çështjet që shtroheshin para gjykatës ishin nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike; nëse adresonte një nevojë urgjente shoqërore; nëse ndërhyrja ishte proporcionale me qëllimin e ndjekur dhe nëse arsyet e caktuara nga autoritetet vendore ishin relevante dhe të mjaftueshme.

GjEDNj-ja vërejtë se parashtuesit ishin gazetarë të cilët kishin botuar artikujt në një gazetë ditore që përmbanin citate nga një draft-raport i Zyrës Regjionale të Auditorit në Languedoc-Roussillon që kritikonte menaxhmentin e këtij regjioni kur J.B ishte kryetar i këshillit. Artikujt përmbanin informacione për menaxhimin e fondeve publike nga zyrtarët e zgjedhur. Gjukata nuk pati asnjë dyshim që kjo temë ishte me interes të përgjithshëm dhe të cilën gazetarët kishin të drejtë ta sillnin në vëmendjen e publikut. Roli i gazetareve hulamtues është pikërisht informimi dhe alarmimi i publikut, sidomos me lajme të këqija, menjëherë posa ata t'i marrin ato informacione. Gazetarët e kishin bërë të qartë në faqen e parë të gazetës që informacionet vinin nga një “draft-raport që mund të amendamentohet pas përgjigjeve nga personat e kritikuar.” Me këtë, sipas gjykatës, gazetarët vepruan në mirëbesim dhe me etikë profesionale. Gjukata vërejtë se raporti në fjalë i ishte komunikuar ish-kryetarit të Këshillit të Regjionit të Languedoc-Roussillon dhe se citate nga raporti u ishin dërguar 70 personave që kritikoheshin në raport. Gjukatësi hetues që kishte vendosur për hetimin e gazetareve kishte theksuar se hetimi kishte dështuar të vërtetojë nëse personi që e ka rrjedhur dokumentin ka qenë i obliguar të ruajë fshehtësinë zyrtare.

Departamenti i Hetimeve të Gjykatës së Apelit në Montpellier kishte vërejtur se personat të cilëve u ishte dërguar raporti nuk kishin obligim të ruanin fshehtësinë zyrtare dhe sipas legjislacionit përkatës vendor, dokumentet në versionin draft nuk klasifikohen automatikisht si konfidenciale. GjEDNj-ja pyeti qeverinë nëse përdorimi i masave të tjera, përveç kontrollimit të zyrave të gazetës, mund të ndihmonin gjykatësin hetues të vërtetonte nëse kishte pasur shkelje të fshtësisë zyrtare. Qeveria kishte dështuar të dëshmonte se pa ndërmarrjen e këtij kontrollimi autoritetet nuk do të mund të kërkonin prova të cilat dëshmonin që kishte pasur vepër penale të shkeljes së fshtësisë zyrtare dhe që informacioni i publikuar ishte marrë në mënyrë të kundërligjshme. Si rezultat, Gjukata konkludoi se qeveria nuk kishte dëshmuar që interesat e përfshira – mbrojtja e burimeve të gazetareve dhe parandalimi i krimit – janë balancuar drejt dhe argumentet e ofruara nga autoritetet për të arsyetuar kontrollimin, sipas gjykatës, janë relevante, por jo të mjaftueshme. Prandaj kontrollimi ishte ndërhyrje joproporcionale dhe kishte



cenuar të drejtën e lirisë së shprehjes së parashtruesve të kërkesës, të garantuar me nenin 10 të Konventës.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)

3.10 Telegraaf Media Nederland Landelijke Media B.V. dhe të tjerët kundër Holandës

Kërkesa nr. 39315/06, 22 shkurt 2013, Dhoma e Seksionit të Tretë

Parashtrues të kërkesës janë kompania Telegraaf Media Nederland Landelijke Media B.V. që boton të përditshmen De Telegraaf dhe gazetarët Joost de Haas dhe Bart Mos.

Në janar të vitit 2006 De Telegraaf publikoi disa artikuj të shkruar nga dy gazetarët në fjalë që aludonin se disa informata rreth pezullimit të hetimeve nga Shërbimi Sekret i Holandës kishte rënë në duar të kriminelëve. Kompania mediale ishte urdhëruar nga Departamenti për Hetime të Brendshme të Policisë Kombëtare që të dorëzonte të gjitha dokumentet që mbante në posedim, gjë që ishte kundërshtuar nga kompania nën arsyetimin se burimi i saj mund të identifikohet nga shenjat e gishtërinjve në dokumente. Gjykata regjionale refuzoi argumentin e kompanisë pasi konstatoi se ndërhyrja ishte arsyetuar me mbrojtjen e sekreteve shtetërore dhe se të drejtat e kompanisë nuk ishin shkelur pasi që nuk është kërkuar që të bashkëpunonte në identifikimin e burimit. Ky aktgjykim ishte konfirmuar nga Gjykata Supreme e Holandës.

Në qershor të vitit 2006 parashtruesit e kërkesës filluan padi civile kundër shtetit për përgjim të telefonave dhe monitorim të dy gazetarëve nga agjentët e shërbimit sekret. Ata pretenduan se këto masa ishin të kundërligjshme pasi që ato në fakt kishin për qëllim identifikimin e burimeve të gazetarëve. Sidoqoftë, gjykata supreme vendosi që mbrojtja e burimeve të gazetarëve nuk ishte absolute dhe kufiri i kësaj të drejte arrihej kur ishte në pyetje mbrojtja e sekreteve shtetërore.



3. E drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetareve



Gjykata ritheksoi që në ato raste ku abuzimi është potencialisht i lehtë dhe me pasoja të dëmshme për një shoqëri demokratike, kontrolli mbikëqyrës [rishikimi] duhet t'i besohet një gjykatësi, ose një trupi të pavarur adekuat.

Në nëntor 2006 dy gazetarët u paraqitën në gjykatën regjionale për t'u marrë në pyetje si dëshmitarë kundër personave që dyshoheshin për rrjedhje të informacioneve nga shërbimi sekret. Ata refuzuan të përgjigjeshin në pyetjet që mund të çonin në identifikimin e personit prej të cilit kishin marrë dokumente të shërbimit sekret. Rrjedhimisht, ata ishin ndaluar për shkak të refuzimit që të zbatonin urdhrin gjyqësor, por u liruan pas disa ditësh pasi që gjykata vendore e njohu rëndësinë e mbrojtjes së burimeve të gazetareve. Gjykata regjionale tutje gjeti që dokumentet tashmë të bëra publike përmes mediave, nuk mund të paraqisnin ndonjë shqetësim real për sigurinë shtetërore. Sipas aktgjykimit, dokumentet e marra nga kompania ishin ekzaminuar nga Instituti për Forenzikë i Holandës, por nuk ishin gjetur shenja gishtërinjsh. Duke u bazuar në nenin 8 dhe 10 të Konventës, kompania dhe gazetarët u ankuan se Holanda kishte cenuar këto dy nene duke i urdhëruar të zbulonin burimet dhe duke përdorur kompetenca të posaçme për t'i përgjuar ata.



Gjykata vërejti se pa mbrojtjen e burimeve, roli vital i mediave si mbikëqyrëse mund të nënvlerësohet ashtu si edhe mundësia e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

a) Përdorimi i kompetencave të posaçme - meqë përdorimi i kompetencave të posaçme nga shteti dhe urdhri për të zbuluar burimet ishin shumë të ndërlidhura me njëri-tjetrin, GjEDNJ-ja vendosi që të shqyrtonte këtë rast nën nenin 8 dhe 10 të Konventës njëkohësisht. Për Gjykatën ishte i padiskutueshëm fakti që në këtë rast kishte ndërhyrje në të drejtat e gazetareve, pasi që përdorimi i kompetencave të posaçme shtetërore ishte bërë për t'iu shmangur obligimit për mbrojtjen e burimeve të gazetareve. Gjykata vërejti se ndërhyrja ishte e parashikuar me legjislacion, ligji ishte i qasshëm dhe efektet e tij mund të parashikoheshin. Pra gazetarët nuk kanë mundur të mos jenë në dijeni që publikimi i dokumenteve të klasifikuara të marra në mënyrë jo të ligjshme do të provokonte veprime që çojnë në zbulimin e burimeve të tyre. Sidoqoftë, ligji në fjalë njëkohësisht duhej të ofronte mbrojtje ndaj ndërhyrjeve arbitrare të autoriteteve publike, sidomos kur rreziku ishte evident pasi që kompetencat e posaçme ushtroheshin në mënyrë sekrete. Edhe pse nuk është pretenduar që në përgjithësi procedurat mbikëqyrëse dhe monitoruese ishin të pamjaftueshme, çështja që u ngre nga Gjykata ishte nëse statusi i dy parashtruesve si gazetarë kërkonte zbatimin e masave mbrojtëse speciale për të siguruar mbrojtjen e burimeve. Gjykata ritheksoi që në ato raste ku abuzimi është potencialisht i lehtë dhe me pasoja të dëmshme për një shoqëri demokratike, kontrolli mbikëqyrës [rishikimi] duhet t'i besohet një gjykatësi, ose një trupi të pavarur adekuat. Një gjë e tillë nuk kishte ndodhur në rastin e gazetareve, pasi që përdorimi i kompetencave të posaçme ishte autorizuar pa rishikim nga një organ i pavarur. Rishikimi i veprimeve të ndërmarra nga autoritetet publike pas ngjarjes nuk ishte i mjaftueshëm, pasi që zbulimi i identitetit të burimeve të gazetareve nuk mund të zhbëhet. Prandaj ligji nuk kishte ofruar masa të nevojshme mbrojtëse sa u përket kompetencave për përgjimin e përdorur ndaj dy gazetareve me qëllim të zbulimit të burimeve të tyre.

Vendimi: shkelje e nenit 8 dhe 10 për parashtruesin e dytë dhe të tretë (në mënyrë unanime)



b) Urdhri për të dorëzuar dokumentet – sipas Gjykatës, urdhri për të dorëzuar dokumentet përbënte ndërhyrje në të drejtën e kompanisë për të marrë dhe dhënë informacione. Ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe ishte bërë për qëllime legjitime të “sigurisë kombëtare” dhe “parandalimit të krimit.” Lidhur me çështjen nëse ndërhyrja ishte në interes publik, Gjykata vërejti se pa mbrojtjen e burimeve, roli vital i mediave si mbikëqyrëse mund të nënvlerësohet ashtu si edhe mundësia e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme. Urdhri për dorëzimin e dokumenteve nuk mund të arsyetohet vetëm me nevojën për të identifikuar zyrtarët e shërbimit sekret që u kishin ofruar dokumente gazetarëve, pasi që ashtu siç e kishte pranuar prokurori, ai qëllim do të mund të arrihej vetëm duke analizuar dokumentet dhe zyrtarët që kishin qasje në ato dokumente. Tutje, ndonëse Gjykata pranoi që shërbimi sekret kishte të drejtë të sigurohej që dokumentet duhet të largoheshin nga qarkullimi, kjo nuk e arsyetonte zbulimin e burimeve të gazetarëve. Edhe ashtu, tërheqja e atyre dokumenteve nuk mund të parandalonte shpërndarjen e informatave që përmbanin ato dokumente, pasi që ishte shumë e mundur që ato dokumente, sipas gazetarëve, tashmë ishin në duar të kriminelëve. Përfundimisht, dorëzimi i dokumenteve nuk ishte i nevojshëm, meqë shikimi i tyre i pasuar me shkatërrim do të mjaftonte si masë. Rrjedhimisht, qeveria nuk kishte ofruar arsye të mjaftueshme dhe relevante për të arsyetuar urdhrin për dorëzimin e dokumenteve.



Dorëzimi i dokumenteve nuk ishte i nevojshëm, meqë shikimi i tyre i pasuar me shkatërrim do të mjaftonte si masë.

Vendimi: shkelje e nenit 10 për parashtruesin e parë (pesë vota në favor dhe dy kundër)

3.11 Saint-Paul Luxembourg kundër Luksemburgut

Kërkesa nr. 26419/10, 18 korrik 2013, Dhoma e Seksionit të Pestë

Parashtruesja e kërkesës, Saint-Paul Luxembourg S.A., është kompani e regjistruar me zyrë në Luksemburg. Më 17 dhjetor 2008 gazeta Contacto që botohej nga parashtruesja e kërkesës, publikoi një shkrim në të cilin përshkruante gjendjen e familjeve që kishin humbur kujdestarinë e fëmijëve. Shkrimi paraqiste rastin e një punëtori social që ishte përgjegjës për dy adoleshentë dhe përmendte emrat e tyre.



3. E drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetareve

Punëtori social u ankua për shkrimin te drejtori i Departamentit Kryesor për Mirëqënie Sociale, i cili paraqiti kallëzim penal te prokurori i përgjithshëm, nën pretendimin se ishte shpifur kundër punëtorit social dhe në përgjithësi kundër sistemit gjyqësor dhe social të Luksemburgut. Më 30 janar 2009 prokuroria inicioi hetime ndaj autorit të shkrimit për shkelje të legjislacionit që mbron të miturit dhe për shpifje. Më pas, një gjykatës hetues lëshoi urdhër për kontrollim dhe sekuestrim në zyrën e kompanisë në kapacitetin e saj si publikuese e Contacto. Më 7 maj policët vizituan zyrat e gazetës dhe gazetari që kishte shkruar artikullin ua dha atyre një kopje të gazetës, fletoren e shënimeve dhe disa dokumente që ishin përdorur gjatë shkrimit të artikullit.



Gjykatësi hetues ka mundur të përdorë masa më pak ndërhyrëse për të vërtetuar identitetin e autorit, sesa urdhri për kontrollim.

Sipas raportit policor, gazetari kishte deklaruar vullnetin e tij për të bashkëpunuar me policinë. Këta të fundit i kishin dhënë një urdhër të gjykatësit hetues, sipas së cilit nëse refuzonte bashkëpunimin, ai do të detyrohej me forcë që të bashkëpunonte. Policia theksoi se të gjitha materialet ishin dorëzuar në mënyrë të vullnetshme dhe se në fakt kishin shërbyer vetëm për të shfajësuar gazetarin. Sipas raportit policor, burimet e gazetarit nuk ishin rrezikuar në asnjë fazë dhe se operacioni ishte kryer pa ndonjë presion dhe në një atmosferë pozitive. Kompania kishte bërë kërkesë për anulim të urdhrit për kontrollim dhe shpallje të pavlefshme të materialeve të sekuestruara, por ajo kërkesë ishte hedhur poshtë nga gjykata vendore dhe urdhri për kontrollim ishte konfirmuar.

Kompania iu drejtua GjEDNj-së. Sipas Gjykatës, kontrollimi dhe sekuestrimi gjatë operacionit të ndërmarrë në kompaninë në fjalë kishte natyrë ndërhyrëse, pavarësisht faktit se gazetari kishte bashkëpunuar me policinë, ngase po të vepronte ndryshe do të detyrohej të bashkëpunonte. Ky incident përbënte ndërhyrje me të drejtën e kompanisë për respektim të “shtëpisë” së saj. Ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe ndiqte dy qëllime legjitime: parandalimin e krimit pasi që masa e caktuar synonte vërtetimin e identitetit të vërtetë të personit që do të përballej me ndjekje penale dhe zbardhjen e rrethanave të një veprje të mundshme penale dhe mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, pasi që shkrimi në fjalë kishte përfshirë individë me emër dhe trajtonte çështje relativisht serioze. Gazetari e kishte nënshkruar artikullin me emrin “Domingos Martins.” Lista zyrtare e gazetareve në Luksemburg nuk përfshinte atë emër, por vetëm emri De Araujo Martins Domingos Alberto figuronte në listë, ndërsa punonte për gazetën Contacto. Ngjashmëria në emra, kombinimi jo i zakonshëm i elementeve të emrave dhe lidhja me gazetën, e bëri të qartë lidhjen në mes të autorit të artikullit dhe personit në atë listë. Në bazë të këtij informacioni, gjykatësi hetues ka mundur të përdorë masa më pak ndërhyrëse për të vërtetuar identitetin e autorit, sesa urdhri për kontrollim. Prandaj në këtë fazë, kontrollimi dhe sekuestrimi i materialeve nuk ishin të nevojshme. Rrjedhimisht, masat e përdorura nuk kanë mundur të jenë në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur.

Vendimi: Shkelje e nenit 8 të Konventës (6 vota në favor dhe 1 kundër)



Lidhur me nenin 10, GjEDNj-ja theksoi se urdhri në fjalë përbënte ndërhyrje me lirinë e parashtruesit për të marrë dhe për të dhënë informacione. Ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe ndiqte qëllim legjitim. Qëllimi i ndërhyrjes ishte gjetja dhe sekuestrimi i “të gjitha dokumenteve ose gjëseneve, pa marrë parasysh formën apo llojin e mediumit, që ndërlidhen me veprat e pretenduara...”. Meqë urdhri ishte formuluar në terma të gjerë, GjEDNj-ja nuk mundi të hedhë poshtë mundësinë si ai kishte për qëllim të zbulonte edhe burimet e gazetarëve. Për më tepër, zyrtarët policorë, të cilët vetë e kishin kryer kontrollimin pa ndonjë masë mbrojtëse procedurale, ishin përgjegjës të vendosnin cilat prova ishin të nevojshme për t’u sekuestruar. Kështu, ata kishin qasje edhe në informacione të cilat gazetari nuk planifikonte t’i publikonte dhe që mund të identifikonin burime të tjera të tij. Marrja e të gjitha të dhënave nga kompjuteri përmes kartelës për ruajtjen e të dhënave, ua mundësoi autoriteteve të mbledhnin informacione që nuk ishin të ndërlidhura me veprat penale të ndjekura. Si rezultat, urdhri për kontrollim dhe sekuestrim nuk ishte mjaftueshëm i kufizuar për të pamundësuar keqpërdorimin e mundshëm të të dhënave. Meqë sipas qeverisë qëllimi i vetëm i kontrollimit ka qenë zbulimi i identitetit të vërtetë të gazetarit që kishte shkruar artikullin, atëherë një formulim më i kufizuar i urdhrin do të ishte i mjaftueshëm. Rrjedhimisht, kontrollimi dhe sekuestrimi i materialeve nuk ishte proporcionalë me qëllimin e ndjekur.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)

3.12 Nagla kundër Letonisë

Kërkesa nr. 73469/10, 16 tetor 2013, Dhoma e Seksionit të Katërt

Parashtruesja e kërkesës, Ilze Nagla është shtetase letoneze e lindur më 1971 dhe banuese në Riga. Në atë kohë ajo punonte për Televizionin Publik të Letonisë (LTV) si producente dhe moderatore e programit javor investigues De Facto.

Më 10 shkurt parashtruesja e kërkesës ishte kontaktuar nga një burim anonim i cili e informoi atë se baza e të dhënave në Shërbimin Shtetëror për Tatime kishte probleme me siguri gjë që mundësonte qasjen në të dhënat e të hyrave, detyrimeve tatimore dhe informatave personale të zyrtarëve publikë, individëve privatë dhe kompanive. Gazetarja pasi informoi institucionin në fjalë për ndërhyrje në sigurinë e bazës së të dhënave, e bëri publike rrjedhjen e këtij lajmi gjatë transmetimit të emisionit De Facto. Një javë pas këtij transmetimi, burimi i saj, i vetidentifikuar si “Neo” filloi të publikonte të dhëna rreth pagave të zyrtarëve publikë përmes Twitter-it. Shërbimi Shtetëror për Tatime kishte ushtruar kallëzim penal dhe më 19 shkurt 2010 parashtruesja e kërkesës ishte marrë në pyetje si dëshmitare. Ajo refuzoi të zbulonte identitetin e burimit, duke cituar



3. E drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetareve



Gjykata gjeti se urdhri për kontrollim ishte shkruar në mënyrë aq të paqartë sa lejonte sekuestrimin e “çfarëdo informacioni” që kishte të bënte me veprën penale që pretendohet se ishte kryer nga burimi i gazetares.

të drejtën për mbrojtjen e burimeve të parashikuar më legjislacionin vendor. Më 11 maj shtëpia e saj ishte kontrolluar dhe laptopi i saj, një kartë për ruajtjen e të dhënave dhe disa pajisje shtesë ishin sekuestruar me urdhër të prokurorit. Urdhri u referohej provave që dëshmonin komunikimin në mes të gazetares dhe personit që policia dyshonte se ishte “Neo” dhe sugjeronte se ajo mund të kishte informacione rreth rrjedhjeve. Urgjenca e ndërmarrjes së kontrollimit arsyetohej me rrezikun e shkatërrimit të të dhënave dhe urdhri për kontrollim mund të aprovohej nga gjykatësi hetues retrospektivisht. Gjykatësi hetues kishte aprovuar urdhrin një ditë pasi ishte bërë kontrollimi i shtëpisë së parashtrueses dhe i njëjti ishte konfirmuar edhe nga gjykata e shkallës së parë ku ajo u ankua. Ombudspersoni kishte lëshuar një opinion me të cilin konkludonte se veprimet e autoriteteve hetuese kishin shkelur të drejtën e lirisë së shprehjes së gazetares. Duke u bazuar në nenin 10, parashtruesja parashtrroi kërkesë në GjEDNJ nën pretendimin se kontrollimi i shtëpisë së saj nënkuptonte se ajo ishte detyruar të ofronte materiale që mundësonin identifikimin e burimit të saj dhe rrjedhimisht i ishte cenuar e drejta për liri të shprehjes.

Sipas GjEDNJ-së materialet e sekuestruara përmbanin jo vetëm materiale që mund të identifikonin burimet e gazetares në rastin konkret, por edhe burimet e informacioneve të tjera. Kontrollimi i shtëpisë së parashtrueses dhe informacionet që mund të zbuloheshin binin në sferën e mbrojtur me nenin 10. Gjykata vlerësoi se kishte ndërhyrje me lirinë e gazetares për të marrë dhe dhënë informacione. Ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe synonte parandalimin e krimit dhe mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Gjykata gjeti se urdhri për kontrollim ishte shkruar në mënyrë aq të paqartë sa lejonte sekuestrimin e “çfarëdo informacioni” që kishte të bënte me veprën penale që pretendohet se ishte kryer nga burimi i gazetares. Urdhri ishte lëshuar përmes një procedure urgjente nga një hetues, me qëllim të vërtetimit të veprës penale të kryer nga “Neo” dhe rolit të parashtrueses në të. Këto arsye, sidoqoftë, nuk ishin relevante dhe të mjaftueshme dhe nuk i përgjigjeshin një nevojë urgjente shoqërore. Tema për të cilën raportoi parashtruesja e kërkesës dhe arsyeja e kontrollimit të shtëpisë së saj, e bëri kontribuimin në debat publik të dyfishtë: informimi i publikut për pagat në sektorin publik gjatë krizës ekonomike dhe problemi me sigurinë e bazës së të dhënave që ishte zbuluar nga burimi i saj. Edhe pse ishte e vërtetë që veprimet e burimit të saj ishin subjekt i një hetimi penal që po zhvillohej, GjEDNJ-ja ritheksoi se e drejta e gazetareve për të mbrojtur burimet nuk duhet të konsiderohet si privilegj që mund t’u jepet apo merret atyre varësisht nga veprimet e ligjshme apo të kundërligjshme të burimeve të tyre, por është aspekt i së drejtës që shkon bashkë me të drejtën për informacion.

Tre muaj pasi autoritetet ndjekëse vendosën që kontrollimi i shtëpisë së parashtrueses ishte i nevojshëm, ata zhvilluan një procedurë urgjente pa përfshirjen e ndonjë autoriteti gjyqësor që do të ekzaminonte proporcionalitetin në mes të interesit publik në zhvillimin e hetimeve në fjalë dhe mbrojtjes së lirisë së shprehjes së gazetares. Bazuar në legjislacionin vendor, një kontrollim i tillë urgjent mund të autorizohet vetëm nëse vonesa do



të shkaktonte shkatërrimin ose dëmtimin e materialeve relevante. Justifikimi i dhënë në urdhër për kontrollim urgjent ishte “parandalimi i shkatërrimit, fshehjes apo dëmtimit të provave dëmtuese”, por nuk përmbante shpjegim të mëtutjeshëm. Informata kërkohej bazuar në lidhjen që ishte bërë në mes të parashtrueses së kërkesës në cilësinë e gazetares dhe I.P. Komunikimi i fundit i gazetares me I.P ishte në ditën e transmetimit të emisionit ku ajo trajtoi këtë temë. Në këto rrethana, vetëm arsyet serioze do të justifikonin urgjencën me të cilën ishte ndërmarrë kontrollimi.

Gjykatësi hetues i cili aprovoi kontrollimin një ditë pasi kishte ndodhur dhe gjykatësi që shqyrtoi ankesën e gazetares, u mjaftuan vetëm duke vlerësuar se kontrollimi nuk kishte të bënte me burimet e gazetares, por nuk shqyrjuan fare nevojën për të vlerësuar nëse të gjitha interesat e përfshirë ishin balancuar drejt. Edhe pse përfshirja e gjykatësit hetues në një rishikim post factum ishte e parashikuar me ligj, ai dështoi të vërtetonte se interesi në hetimin për të siguruar prova tejkalohte interesin publik në mbrojtjen e shprehjes së gazetarit, duke përfshirë mbrojtjen e burimeve dhe dorëzimin e materialit të hulumtuar. Arsyetimi i gjykatave vendore se materialet e sekuestruara ndërlidheshin me krimet kibernetike nuk ishte i mjaftueshëm sipas GjEDNJ-së. Po ashtu, nuk kishte ndonjë provë që sugjeronte se parashtruesja ishte përgjegjëse për shpërndarjen e të dhënave personale, ose se ishte përfshirë në ato ngjarje, përveçse në kapacitetin e saj si gazetare. Rrjedhimisht, autoritetet vendore kishin dështuar të ofronin arsye relevante dhe të mjaftueshme për ndërhyrjen në fjalë.



Edhe pse përfshirja e gjykatësit hetues në një rishikim post factum ishte e parashikuar me ligj, ai dështoi të vërtetonte se interesi në hetimin për të siguruar prova tejkalohte interesin publik në mbrojtjen e shprehjes së gazetarit, duke përfshirë mbrojtjen e burimeve dhe dorëzimin e materialit të hulumtuar.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)



Seancë gjyqësore e mbajtur nga Dhoma e Madhe (2016)
© Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut

4.

Sinjalizimi

-
- 4.1 Guja kundër Moldavisë**
 - 4.2 Marchenko kundër Ukrainës**
 - 4.3 Kudeshkina kundër Ruisë**
 - 4.4 Heinisch kundër Gjermanisë**
 - 4.5 Bucur and Toma kundër Rumanisë**
 - 4.6 Matúz kundër Hungarisë**
 - 4.7 Görmüş dhe të tjerët kundër Turqisë**
-



Pas një seance gjyqësore të mbajtur nga Dhoma e Madhe (2015)
© Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut



4. Sinjalizimi

4.1 Guja kundër Moldavisë

Kërkesa nr. 14277/04, 12 shkurt 2008, Dhoma e Madhe



Ndonëse shërbyesit civilë, si rasti i parashtruesit, gëzojnë të drejtën e lirisë së shprehjes, ata sidoqoftë kanë obligim ndaj punëdhënësit të tyre që të jenë besnikë dhe të përmbytur.

Parashtruesi i kërkesës, Iacob Guja, i lindur më 1970 është shtetas moldav dhe jeton në Chişinău. Në atë kohë, ai ishte drejtor i Zyrës për Komunikim me Media të Prokurorisë së Përgjithshme të Moldavisë. Rasti kishte të bënte me largim nga puna për shkak të rrjedhjes së dy letrave nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm.

Në janar të vitit 2003 Presidenti i Moldavisë, Vladimir Voronin, vizitoi Qendrën për Luftimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit ku do të diskutohet rreth ushtrimit të presionit nga zyrtarët publikë ndaj organeve për zbatimin e ligjit. Presidenti deklaroi gjatë debatit se duhej luftuar korrupsionin dhe ftoi zyrtarët e institucioneve për zbatimin e ligjit të shpërfillin presionin ndaj tyre. Kjo deklaratë ishte raportuar në shumë media. Disa ditë më vonë, parashtruesi i kërkesës ia dha gazetës Jurnal de Chişinău dy letra të pranuar nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm. Letrat nuk përmbanin ndonjë shenjë të konfidencialitetit.

Letra e parë, me llogo të Parlamentit, i ishte drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm nga zëvendëskryetari i Parlamentit Vadim Mişin. Përmes letrës nga Prokurori i Përgjithshëm kërkohet që të “përfshihej personalisht” në rastin e katër policëve që akuzoheshin për arrestim të paligjshëm dhe keqtrajtim të të arrestuarve. Mişin theksonte në letër se zyrtarët policorë të cilët kishin kërkuar mbrojtje nga ndjekja penale i përkisnin një ndër “skuadrave më të mira” të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe se ata po pengoheshin në kryerjen e detyrës zyrtare “nga zyrtarët e Zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme.” Ai po ashtu pyeti në letër nëse “Zëvendësprokurori i Përgjithshëm po e luftonte krimin apo policinë.” Letra e dytë, me llogo të ministrisë, i ishte drejtuar zëvendësprokurorit të përgjithshëm nga zëvendësministri i MPB-së. Aty, ndër të tjera, shpërfaqej fakti se një nga katër policët në fjalë ishte punësuar në MPB edhe pse ishte dënuar për vepra penale. Më 31 janar 2003 gazeta Jurnal de Chişinău publikoi artikullin e titulluar “Vadim Mişin frikëson prokurorët” ku thuhej se keqpërdorimi i autoritetit ishte bërë problem i madh në Moldavi. Si shembull, gazeta botoi letrat dhe përmendi përpjekjet e Mişin-it për të mbrojtur katër policët.

Më pas, parashtruesit Guja i ishte kërkuar nga Prokurori i Përgjithshëm të shpjegonte se si kishin rrjedhur letrat në shtyp. Më 14 shkurt 2003 parashtruesi pranoi se ai i kishte rrjedhur letrat duke theksuar se veprimi në linjë me fushatën kundër-korrupsion të Presidentit të shtetit, me qëllim që të krijonte imazh pozitiv të Zyrës së Prokurorit dhe se letrat nuk ishin konfidenciale. Prokurori I.D. që dyshohej se ia kishte dhënë letrat parashtruesit të kërkesës, ishte larguar më vonë nga puna. Parashtruesi mohoi se letrat i kishte



marrë nga prokurori I.D. dhe shprehu shqetësimet e tij rreth largimit të prokurorit. Më 3 mars 2003 edhe parashtruesi ishte përjashtuar nga puna për shkelje të rregullores së brendshme, nën arsyetimin se kishte dështuar të mernte aprovim nga mbikëqyrësit e tij për të publikuar letrat.

Padia e tij kundër prokurorisë për kthim në vendin e punës në të cilën ai theksoi se letrat e publikuara nuk ishin sekrete dhe se ai nuk ishte i obliguar të konsultonte mbikëqyrësit e tij, nuk ishte e suksesshme. Gazeta bëri kallëzim penal kundër Mişin-it për ndërhyrje në procedurë penale, por nuk pati sukses. Më 14 mars 2003 gazeta publikoi edhe një artikull të titulluar “Mişin ka nisur masa të rrepta kundër prokurorëve”. Artikulli theksoi se Prokurori i Përgjithshëm i ishte nënshtruar presionit nga Mişin-i për të identifikuar dhe dënuar përgjegjësit që zbuluan letrën e tij dhe se i njëjti kishte ndikuar në punësimin apo largimin e zyrtarëve në Prokurorinë e Përgjithshme. Një vit më herët, 30 prokurorë me përvojë ishin larguar nga puna. Artikulli po ashtu përshkroi rastin e largimit të parashtruesit nga puna. Pasi humbi padinë për kthim në vendin e punës në të gjitha gjykata vendore, parashtruesi iu drejtua GjEDNj-së nën pretendimin se ishte larguar nga puna për shkak të rrjedhjes së dy letrave. Ai e bazoi kërkesën në nenin 10 të Konventës.



Sinjalizimi nga shërbyesit civilë për veprime të paligjshme ose parregullësi në vendin e punës duhet të gëzojë mbrojtje.

Sipas GjDNj-së, largimi nga puna i parashtruesit të kërkesës për shkak të publikimit të dy letrave përbënte ndërhyrje nga autoritetet publike në të drejtën e tij për liri të shprehjes. Ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe kishte për qëllim të parandalonte publikimin e informacioneve të marra në konfidencë. Ndonëse shërbyesit civilë, si rasti i parashtruesit, gëzojnë të drejtën e lirisë së shprehjes, ata sidoqoftë kanë obligim ndaj punëdhënësit të tyre që të jenë besnikë dhe të përmbajtur. Gjykata pohoi se nuk ka trajtuar më herët një rast në të cilin një shërbyes civil ka zbuluar publikisht dokumente të brendshme. Shërbyesit civilë [të përhershëm, ose të përkohshëm] gjatë punës së tyre mund të vihen në dijeni për ekzistimin e dokumenteve sekrete, zbulimi ose publikimi i të cilave do të ishte me interes të madh publik. Në këto raste, sinjalizimi nga shërbyesit civilë për veprime të paligjshme ose parregullësi në vendin e punës duhet të gëzojë mbrojtje. Për shembull, kur shërbyesi civil është i vetmi person ose pjesë e një grupi të vogël të personave që kanë dijeni se çfarë ndodh, atëherë ata janë në pozitën më të mirë që të ndërmarrin veprime. Mirëpo, nëse merret parasysh obligimi i shërbyesve civilë për të qenë diskretë, raportimi në raste të tilla fillimisht duhet të bëhet te mbikëqyrësi, ose ndonjë autoritet kompetent. Vetëm kur qartësisht nuk është praktike, atëherë ajo informatë, si mundësi e fundit mund t'i zbulohet publikut. Për këtë arsye, gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes në lirinë e shprehjes së shërbyesit civil, gjykata shqyrtoi nëse parashtruesi kishte pasur mjete tjera efektive në dispozicion për të adresuar parregullsinë në fjalë. Në rastin konkret, për shkak të mungesës së ndonjë legjislacioni vendor që rregullon raportimin e parregullsive, parashtruesi nuk kishte në dispozicion kanale për raportim, përveç te mbikëqyrësi i tij. Për më tepër, zyra e prokurorit kishte dhënë përshtypjen që i ishte nënshtruar ndikimit politik. Në rrethana të tilla mund të arsyetohet rrjedhja e informacionit jashtë zyrës së prokurorit në media.



4. Sinjalizimi



Për shkak të mbulimit të madh medial të rastit, sanksioni mund të kishte efekt jo vetëm te zyrtarët e prokurorisë, por edhe te shërbyesit tjerë civilë.

Sipas GjEDNj-së, në vlerësimin e proporcionalitetit të një ndërhyrjeje në të drejtën e lirisë së shprehjes së shërbyesve civilë, duhet të merren parasysh disa faktorë: nëse ka interes publik në zbulimin e informacionit, nëse informatat apo dokumentet e zbuluara janë të vërteteta dhe autentike, nëse punëtori ka vepruar në mirëbesim dhe në fund çfarë

sanksioni është shqiptuar dhe pasojat e tij. Në rastin konkret, sa i përket interesit publik, letrat e rrjedhura nga parashtruesi, autenciteti i të cilave nuk ishte kontestuar, trajtonin çështjen e ndarjes së pushteteve, sjelljes së gabuar të politikanëve të rangut të lartë dhe qasjes së qeverisë ndaj brutalitetit të policisë. Nuk kishte dyshim që këto ishin çështje të rëndësishme që bien në sferën e debateve politike në një shoqëri demokratike, për të cilat publiku ka interes legjitim që të jetë i informuar. Lidhur me dëmtimin e

imazhit që do të pësonte Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, gjykata e kishte parasysh që konkludimi i gazetës në artikujt e saj ka mundur të ketë efekte negative në publik rreth pavarësisë së atij institucioni. Mirëpo, interesi i publik për t'u informuar për ndikimet e ushtruara në zyrën e prokurorit ishin aq të rëndësishme në një shoqëri demokratike, sa tejkalonin interesin për të mbajtur besimin e publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e prokurorisë së shtetit. Për më tepër, Gjykata vlerësoi se qëllimi i parashtruesit ishte kontribimi në luftën kundër korrupsionit dhe se ai kishte vepruar në mirëbesim. Në fund, sanksioni i shqiptuar kundër parashtruesit ishte i ashpër dhe përveç ndikimit që mund të kishte në karrerën e tij, ai mund të kishte efekt frenues në zyrtarët e tjerë të prokurorisë dhe t'i shkurajonte ata nga raportimi i parregullive. Për më tepër, për shkak të mbulimit të madh medial të rastit, sanksioni mund të kishte efekt jo vetëm te zyrtarët e prokurorisë, por edhe te shërbyesit tjerë civilë. Si përfundim - duke marrë parasysh rëndësinë e së drejtës së lirisë së shprehjes në çështje me interes të përgjithshëm, të drejtën e shërbyesve civilë dhe punëtorëve të tjerë që të raportojnë sjellje të kundërligjshme dhe parregullësi në vendin e tyre të punës, të drejtat dhe përgjegjësitë e punëtorëve ndaj punëdhënësve të tyre dhe të drejtën e punëdhënësve të menaxhojnë stafin e tyre - ndërhyrja në të drejtën e lirisë së shprehjes së parashtruesit, sidomos e të drejtës së tij për të dhënë informacione nuk ishte nevojshme në një shoqëri demokratike.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)



4.2 Marchenko kundër Ukrainës

Kërkesa nr. 4063/04, 19 maj 2009, Dhoma e Seksionit të Pestë

Parashtruesi i kërkesës, Mykhaylo Marchenko, i lindur më 1946 është shtetas ukrainas dhe banues në Pasiky-Zubrytski. Në atë kohë ishte mësues dhe kryetar i sindikatës së shkollës ku punonte.

Pas disa akuzave që kishte ngritur për keqpërdorimin e pronës së shkollës, më 1997 Marchenko iu drejtua disa herë një shërbimi auditues përgjegjës me kërkesë për vlerësimin e shfrytëzimit të fondeve nga institucionet shtetërore. Ai pretendonte në veçanti se drejtoresha e shkollës në fjalë kishte keqpërdorur ndihmën humanitare dedikuar shkollës, kishte shfrytëzuar veturën e shkollës, kishte përdorur TV-në dhe pajisjet tjera për qëllime private dhe kishte marrë tulla nga muret e shkollës. Autoriteti auditues nuk gjeti prova që dëshmonin keqpërdorimin e pronës së shkollës nga drejtoresha. Marchenko ushtroi dy kallëzime penale kundër drejtoreshës, të cilat ishin hedhur poshtë në mungesë provash.



Parullat përmbanin akuzë të rënda të cilat në mungesë faktesh kanë mundur të dëmtojnë seriozisht reputacionin e drejtoreshës.

Më pas, disa përfaqësues të sindikatës që udhëhiqte parashtruesi i kërkesës organizuan një protestë në zyrën e administratës lokale me parulla që akuzonin drejtoreshën për sjellje të pahijshme. Drejtoresha inicioi ndjekje penale private kundër Marchenkos për vepra të ndryshme penale të cilat ndërkohë ishin modifikuar, por përfundimisht ai u akuzua për akuzim të rrejshëm për krime serioze [shpifje] dhe fyerje. Më 2001 ai u shpall fajtor duke u dënuar me një vit dënim me burg me kusht dhe gjobë për akuzat publike dhe të pabazuara kundër drejtoreshës. Parashtruesi u ankua në GjEDNj, ndër të tjera, se dënimi i tij për shpifje ishte në kundërshtim me nenin 10 të Konventës.

GjEDNj-ja theksoi se dënimi për shpifje sipas kodit penal përbënte ndërhyrje në të drejtën e parashtruesit për liri të shprehjes, ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes së reputacionit të drejtoreshës. Gjykata duhej të vlerësonte nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe nëse në rastin konkret ishin balancuar mbrojtja e lirisë së shprehjes së parashtruesit të kërkesës dhe mbrojtja e reputacionit të drejtoreshës së shkollës. Gjykata ritheksoi se sinjalizimi në sektorin publik për sjellje të kundërligjshme, ose parregullsi gëzonte mbrojtje. Mirëpo, edhe pse ai ishte përfaqësues i sindikatës së shkollës dhe i përfshirë në një çështje me interes publik, parashtruesi kishte obligim të respektoje reputacionin e të tjerëve, të drejtën e prezumimit të pafajësisë dhe obligohej të ishte besnik dhe diskret ndaj punëdhënësit



4. Sinjalizimi

të tij. Po ashtu, zbulimi i informacionit duhej fillimisht të bëhej te mbikëqyrësi ose autoriteti kompetent dhe vetëm si alternativë e fundit te publiku. Bazuar në këto parime, Gjykata vlerësoi se fakti që ai kishte paraqitur kallëzime penale kundër drejtoreshës nuk nënkuptonte se ai kishte vepruar në keqbesim, sepse kishte vepruar në emër të sindikatës dhe po ashtu ai posedonte disa prova. Rrjedhimisht, ndërhyrja e bërë për shkak të paraqitjes së kallëzimeve penale nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.



Dënimi me një vit burg [edhe pse me kusht] për shpifje gjatë debatit me interes publik, nuk mund të arsyetohej.

Sa i përket dënimit të parashtruesit edhe për pjesëmarrje në protestën në fjalë, GjED-Nj-ja vërejtë se gjykatat vendore nuk e kishin marrë parasysh argumentin e parashtruesit sipas të cilit ai nuk e kishte organizuar personalisht protestën. Në anën tjetër, parullat përmbanin akuza të rënda të cilat në mungesë faktesh kanë mundur të dëmtojnë seriozisht reputacionin e drejtoreshës. Për më tepër, as parashtruesi e as mbështetësit e tij nuk kishin përdorur masat procedurale në dispozicion për të sfiduar paefektshmërinë e hetimeve. Rrjedhimisht, gjykata pranoi të drejtën e autoriteteve vendore që të rregullonin ushtrimin e lirisë së shprehjes. Mirëpo në rastin konkret, dënimi me një vit burg [edhe pse me kusht] për shpifje gjatë debatit me interes publik, nuk mund të arsyetohej. Vetë natyra e sanksionit të tillë, edhe pse asnjëherë nuk u ekzekutua, mund të kishte efekt frenimi në diskutimet publike. Për këto arsye, gjykatat vendore kishin tejkaluar ndërhyrjen e nevojshme në të drejtën e lirisë së shprehjes së parashtruesit.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)

4.3 Kudeshkina kundër Ruisisë

Kërkesa nr. 29492/05, 26 shtator 2009, Dhoma e Seksionit të Parë

Parashtruesja e kërkesës, Olga Kudeshkina, e lindur me 1951 është shtetase ruse dhe banuese në Moskë. Në atë kohë ajo kishte qenë gjykatëse për më shumë se 18 vjet në Gjykatën e Qytetit të Moskës.

Rasti kishte të bënte me pretendimet e gjykatëses Kudeshkina se më 2004 ajo ishte larguar nga sistemi gjyqësor për shkak se kishte akuzuar publikisht zyrtarë të lartë gjyqësorë për ushtrim të presionit tek ajo në një rast penal të profilit të lartë. Më 2003 Kudeshkina ishte caktuar gjykatëse në një rast të keqpërdorimit të pozitës zyrtare nga polici hetues Zaystev. Polici hetues akuzohej për ndërmarrjen e kontrollimit të paau-



torizuar në një rast që përfshinte dyshime për kontrabandë me orendi në disa qendra të blerjes në Moskë. Palët nuk u pajtuan para GjEDNj-së rreth rrethanave të tërheqjes së gjykatëses Kudeshkina nga rasti. Vetë gjykatësja kishte deklaruar se Kryetarja e Gjykatës së Qytetit të Moskës e kishte larguar atë nga rasti më 4 korrik 2003 pa arsyetim, përderisa qeveria pretendonte se rasti ishte tërhequr nga gjykatësja dhe i ishte caktuar një gjykatësi më 23 korrik 2003, pasi që ajo ishte vonuar në shqyrtimin e tij.

Në fillim të dhjetorit 2003, Kudeshkina, e cila njëkohësisht po kandidonte në zgjedhje, kishte dhënë disa intervista në gazeta ruse dhe radio. Ajo kishte deklaruar që kryetarja e Gjykatës së Qytetit të Moskës i kishte bërë presion gjatë shqyrtimit të rastit kundër hetuesit Zaytsev. Ajo po ashtu tha se ky nuk ishte rasti i parë kur një gjykatë ruse ishte përdorur si instrument për manipulim komercial, politik dhe personal. Ajo kishte bërë ankesë në Panelin e Lartë për Kualifikim Gjyqësor për presionin e ushtruar ndaj saj lidhur me rastin Zaytsev, por nuk kishte pasur sukses. Në ndërkohë, Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Moskës kishte filluar procedurën për përjashtimin nga gjykata të parashtrueses së kërkesës, nën arsyetimin se sjelljet e saj e kishin fyer sistemin gjyqësor, mund të nënvlerësonin autoritetin e gjyqësorit dhe se kishte zbuluar informacione rreth rastit të hetuesit Zaytsev. Ankesat e saj kundër këtij vendimi ishin hedhur poshtë. Për këtë arsye ajo iu drejtua GjEDNj-së nën pretendimin se largimi i saj nga gjykata për shkak të deklaratave të bëra ishte në kundërshtim me nenin 10 të Konventës.

Gjykata ritheksoi se neni 10 aplikohet edhe në vende të punës dhe se shërbyesit civilë gëzojnë të drejtën e lirisë së shprehjes. Zbulimi i informacioneve të marra gjatë punës, edhe kur zbulimi i tyre është në interes të publikut, duhet të shqyrtohen nga perspektiva e obligimit të punëtorëve për besnikëri dhe diskrecion ndaj punëdhënësit. Lidhur me pretendimin se parashtruesja kishte zbuluar fakte rreth rastit gjyqësor, autoritetet vendore nuk ishin bazuar në ndonjë deklaratë specifike dhe Gjykata nuk vërejti asgjë në intervistat e përmendura që mund të konsiderohej si “zbulim i informacionit”. Edhe pse parashtruesja gjatë deklarimeve i ishte referuar përvojës së saj në rastin Zaytsev dhe presionit të ushtruar nga kryetarja e gjykatës, ajo deklaroi vetëm mbështetje kritikën e saj për rolin e kryetarëve të gjykatës dhe në asnjë mënyrë nuk përbënte zbulim të informacioneve të klasifikuara.

Lidhur me faktet që mbështesnin pretendimet e saj, qeveria deklaroi se nuk kishte prova që dëshmonin se kryetarja e gjykatës ishte munduar të ndikonte te Kudeshkina. Ndonëse ishte e vështirë të kuptohej përmbajtja e komunikimeve private në mes të parashtrueses dhe kryetares së gjykatës [në mungesë provash], Gjykata i kushtoi rëndësi mënyrës se si parashtruesja ishte larguar nga rasti Zaytsev. Sipas Gjykatës, parashtruesja kishte kritikuar publikisht sjelljen e disa zyrtarëve dhe pretendonte se presioni mbi gjyqtarë ishte praktikë e zakonshme në gjykatat ruse dhe kjo përbënte padyshim një temë të rëndësishme dhe me interes publik. Rrjedhimisht, tolerohej një shkallë ekzagjerimi dhe përgjithësimi, pasi komentet e saj ishin të bazuar në fakte dhe



Tolerohet një shkallë ekzagjerimi dhe përgjithësimi, pasi komentet e saj ishin të bazuar në fakte dhe përmbanin opinion.



4. Sinjalizimi

përmbanin opinion. Sa i përket shqetësimeve që ajo kishte shprehur rreth paanësisë së Gjykatës së Qytetit të Moskës, Gjykata i pranoi shqetësimet e ngritura nga Kudeshkina. Mirëpo, argumentet e saj nuk ishin marrë parasysh fare gjatë shqyrtimeve procedurale vendore gjë që kishte rezultuar në mangësi procedurale. Përfundimisht, largimi nga shërbimi gjyqësor ishte sanksion joproporcional që mund të shkaktonte efekt frenues në gjykatës të tjerë të cilët mund të dëshironin të kontribuonin në diskutime publike rreth efikasitetit të sistemit gjyqësor.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (katër vota pro dhe tri vota kundër)

4.4 Heinisch kundër Gjermanisë

Kërkesa nr. 28274/08, 21 tetor 2011, Dhoma e Seksionit të Pestë

Parashtruesja e kërkesës, Brigitte Heinisch, e lindur më 1961 është shtetase gjermane dhe banuese në Berlin. Në atë kohë ajo punonte si infermiere në Vivantes Netzwerk für Gesundheit GmbH, kompani e specializuar për kujdes shëndetësor dhe përkujdesje ndaj të moshuarve dhe shumica e saj ishte në pronësi të shtetit.

Nga janari 2002 ajo punoi në një shtëpi të pleqve, pacientët e të cilës varehin nga ndihma speciale. Ajo së bashku me kolegët e saj e kishin informuar rregullisht menaxhmentin se ishin të mbingarkuara me punë për shkak të shkurtimeve të vendeve të punës dhe se shërbimet nuk regjistroheshin siç duhet. Ndërkohë, ajo ishte sëmurë disa herë dhe nuk mund të punonte derisa një certifikatë mjeksore dëshmonte se kjo i kishte ndodhur si pasojë e punës. Një inspektim në shtëpinë e pleqve gjeti mangësi serioze dhe mungesë të dokumentimit të kujdesit të ofruar. Këshilltarja ligjore e Heinisch-it iu drejtua kompanisë me një letër, me të cilën e informoi për mungesën e pastërtisë ndaj pacientëve dhe pyeti kompaninë se si planifikonte të adresonte këtë çështje. Pasi menaxhmenti refuzoi akuzat, parashtruesja ushtroi kallëzim penal kundër kompanisë duke e akuzuar për dështim në ofrimin e kujdesit për pacientë, kallëzim ky që ishte hedhur poshtë nga prokurori publik.

Kompania e largoi parashtruesen nga puna në janar 2005 nën arsyetimin se sëmurej shpesh, vendim ky që do të hynte në fuqi në mars. Ndërkohë, së bashku me miqtë e saj dhe e mbështetur nga sindikata, ajo shpërndau fletëpalosje me të cilat denonconte



largimin e saj nga puna si masë disiplinore politike më qëllim të frikësimit të punëtorëve të tjerë dhe përmendtte që kishte ushtruar kallëzimin penal. Kompania, e cila përmes fletëpalosjeve u informua për kallëzim penal, e largoi nga puna pa njoftim paraprak për shkak të shpërndarjes së tyre. Parashtruesja nuk pati sukses me paditë e saj në gjykata vendore me të cilat kërkonte kthim në vendin e punës. Ajo iu drejtua GjEDNj-së nën pretendimin se largimi nga puna për shkak të fletëpalosjeve përbënte shkelje të nenit 10 të Konventës.

Sipas Gjykatës, kallëzimi penal i paraqitur nga parashtruesja kualifikohej si sinjalizim, brenda fushëveprimit të nenit 10 dhe largimi i saj nga puna si pasojë e tij dhe vendimet e ndërlidhura, përbënin ndërhyrje në të drejtën e saj për liri të shprehjes. Ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes së reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve, pra reputacionit të biznesit dhe interesave të punëdhënësit. Sa i përket proporcionalitetit, Gjykata konsideroi se kriteret e vendosura në rastin Guja kundër Moldavisë, rast ky që kishte të bënte me një punëtor të shërbimit publik, aplikoheshin edhe në marrëdhënjet e punës të rregulluara me të drejtën private. Andaj, në këtë rast, autoritetet duhet të balanconin të drejtën e punëtorëve të sinjalizojnë sjelljet e kundërligjshme dhe parregullsitë dhe të drejtën e punëdhënësit të ruajë reputacionin dhe interesat komerciale.

Duke marrë parasysh dobësinë e pacientëve të vjetër dhe nevojën për parandalimin e abuzimit të tyre, informacioni i zbuluar ishte padyshim në interes publik dhe kështu u përmbush kriteri i parë nga rasti Guja kundër Moldavisë. Sa i përket kriterit të dytë, nëse kishte kanale alternative të raportimit, parashtruesja i kishte informuar disa herë mbikëqyrësit e saj për parregullsi dhe i kishte paralajmëruar për kallëzim penal. Sa i përket kriterit tjetër, nëse informata e zbuluar ishte autentike, pretendimeve të parashtrueses nuk i mungonin faktet, pasi që gjatë inspektimit ishin evidentuar parregullsi dhe nuk kishte arsye për të dyshuar që parashtruesja kishte raportuar informacione të pasakta. Po ashtu nuk kishte arsye të dyshohej se parashtruesja nuk e plotësonte edhe kriterin e katërt: pra që kishte vepruar në mirëbesim. Edhe pse në formulimin e kallëzimit penal kishte një shkallë ekzagjerimi dhe përgjithësimi, akuzat e saj nuk ishin tërësisht të pabazuara në fakte dhe nuk përbënin sulm personal kundër punëdhënësit të saj.

Edhe pse ajo kishte ardhur në përfundim se ishte i nevojshëm sinjalizimi i jashtëm, ajo nuk u ishte drejtuar menjëherë mediave, por kishte kërkuar ndihmën e avokates, me qëllim të paraqitjes së kallëzimit penal. Lidhur me kriterin e pestë që ka të bëjë me dëmet e shkaktuara ndaj punëdhënësit, ndonëse akuzat kishin qenë paragjyquese për kompaninë, interesi i publikut për të qenë i informuar për parregullsitë në ofrimin e shërbimeve për të moshuarit nga një kompani shtetërore ishte aq i rëndësishëm sa tejkalonte interesin e kompanisë për të mbrojtur reputacionin e saj. Në fund, sa i përket sanksionit, parashtruesja ishte dënuar me dënimin më të rëndë sipas ligjit të punës. Kjo jo vetëm që kishte pasojë në karrierën e saj, por kishte mundësi të kishte efekt



Gjykata konsideroi se kriteret e vendosura në rastin Guja kundër Moldavisë aplikoheshin edhe në marrëdhënjet e punës të rregulluara me të drejtën private.



4. Sinjalizimi

frenues dhe të dekurajonte punëtorët në përgjithësi, e sidomos punëtorët e kompanisë në fjalë, që të raportnin veprimet e paligjshme. Prandaj, largimi i nga vendi i punës pa paralajmërim ishte joproporcional dhe gjykatat vendore kishin dështuar të balanconin nevojën për të mbrojtur reputacionin e kompanisë me nevojën për të mbrojtur të drejtën e lirisë së shprehjes së parashtrueses.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)

4.5 Bucur and Toma kundër Rumanisë

Kërkesa nr. 40238/02, 8 prill 2013, Dhoma e Seksionit të Tretë

Parashtruesit e kërkesës, Constantin Bucur dhe Mircea Toma, të lindur më 1952, dhe Sorana Toma, e lindur më 1985, janë shtetas rumunë të cilët jetojnë në Bukuresht. Më 1996 Bucur punonte në Departamentin për Monitorimin e Komunikimit në Agjencinë Rumune të Inteligjencës (SRI) me bazë në Bukuresht.



Parashtruesi mund të kishte informuar vetëm mbikëqyrësit e tij, mirëpo parregullsitë që ai kishte zbuluar kishin të bënin me ata. Prandaj, vështirë se një ankesë e brendshme e parashtruesit do të rezultonte me hetim apo ndalim të praktikave të paligjshme.

Bucur-i ishte përgjegjës për monitorimin dhe incizimin e komunikimeve telefonike të personave që figuronin në një listë. Ai vërejti disa parregullsi në atë listë. Emrat e personave që duhej përgjuar ishin të shënuar me laps dhe lista nuk përmbante ndonjë arsyetim për përgjimin e disa prej gazetarëve, politikanëve dhe biznesmenëve. Bucur-i njoftoi mbikëqyrësin e tij për parregullsitë e evidentuara, por u qortua nga ai. Bucur-i pastaj kontaktoi një deputet që ishte edhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Mbikqyrjen e SRI-së. Sipas deputetit, nëse kjo çështje do të shkonte në Parlament, atëherë hetimi ndaj agjencisë së inteligjencës vetëm do të vonohej dhe i rekomandoi parashtruesit të kërkesës t'i bënte publike të gjeturat e tij në një konferencë për media. Bucur-i mbajti konferencë për media ku publikoi 11 audiokaseta që përmbanin komunikime telefonike të disa gazetarëve dhe politikanëve. Konferenca u raportua nga mediat botërore.

Më 31 korrik 1996 filluan hetimet penale kundë Bucur-it nga një gjykatë ushtarake fillimisht për mbledhje dhe zbulim të informacionit sekret dhe pastaj për vjedhje të audiokasetave. Bucur-i kërkoi informata nga SRI-ja që të mbështeste gjetjet e tij, por gjykata ushtarake vendosi që kërkesat e tij nuk ishin relevante për rastin. Bucur-i deklaroi se nuk kishte zbuluar sekrete shtetërore por dëshmi që tregonin për manipulime politike të



bëra nga SRI-ja. Më 11 prill 1997, gjykata dëgjoi si dëshmitar gazetarin Mircea Toma i cili pretendonte se të drejtat e tij ishin cenuar me përgjimin e telefonatës bërë vajzës së tij që në këtë rast është parashtruesja e tretë. Më 20 tetor 1998, gjykata ushtarake dënoi Bucur-in me dy vjet burg për vjedhje dhe publikim të paligjshëm të informatave sekrete. Gjykatat tjera konfirmuan aktgjykimin dënues ndaj Bucur-it. Bazuar në nenin 10, Bucur-i u ankua së dënimi i tij përbënte shkelje të këtij neni. Dy parashtruesit tjerë, Mircea Toma, i cili punonte në stafin redaktues të gazetës A.C. dhe vajza e tij Sorana Toma, duke u bazuar në nenin 8 u ankuan për përgjim të bisedave të tyre.

Sipas GjEDNj-së, dënimi me burg i parashtruesit përbënte një ndërhyrje në të drejtën e tij për liri të shprehjes, ndiqte qëllimin legjitim të parandalimit dhe dënimin e veprave që kërcënonin sigurinë shtetërore. Në këtë rast, nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej baza ligjore me të cilën u dënua parashtruesi, sepse edhe ashtu, një masë e tillë nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Lidhur me çështjen nëse parashtruesi kishte mënyra të tjera për të raportuar informatat, në SRI nuk ekzistonte asnjë procedurë zyrtare. Parashtruesi mund të kishte informuar vetëm mbikëqyrësit e tij, mirëpo parregullsitë që ai kishte zbuluar kishin të bënin me ata. Prandaj, vështirë se një ankesë e brendshme e parashtruesit do të rezultonte me hetim apo ndalim të praktikave të paligjshme. Sa i përket ankesës së ushtruar në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Inteligjencës së Rumanisë, parashtruesi e kishte kontaktuar një deputet që ishte anëtar i atij komisioni, i cili e kishte këshilluar parashtruesin së një ankesë e tillë nuk do të ishte e dobishme. Prandaj, gjykata nuk ishte e bindur se një ankesë zyrtare në këtë komision do të ishte masë efektive për të adresuar parregullsitë.

Gjykata po ashtu vërejti që Rumania kishte aprovuar legjislacion special për të mbrojtur sinjalizuesit në shërbimin publik. Sidoqoftë, ligjet e reja të cilat ishin për t'u lavdëruar nëse merret parasysh fakti që shumë pak shtete i kanë aprovuar, kishin hyrë në fuqi pas rastit të parashtruesit dhe nuk ishin të aplikueshme në rastin e tij. Rrjedhimisht, zbulimi i informacioneve drejtpërsëdrejti në publik justifikohet. Lidhur me interesin publik për informacionet e raportuara, gjykata vërejti se komunikimet telefonike kishin një rëndësi të veçantë në shoqëri, e cila gjatë regjimit komunist ishte mësuar me një politikë të fshehtë të përgjimit nga shërbimet sekrete. Shoqëria civile ishte e prekur nga informata e zbuluar, sepse u bë e ditur që bisedat e kujt do mund të përgjoheshin. Keqpërdorime të bëra nga zyrtarë të profilin të lartë që preknin themelet demokratike të shtetit kishin të bënin me çështje tejet të rëndësishme në një shoqëri demokratike për të cilat publiku kishte interes legjitim të informohej. Gjykatat vendore nuk morën parasysh këto argumente të parashtruesit.

Sa i përket vërtetësisë së informacioneve të zbuluara, parashtruesi i kërkesës kishte vërejtur disa parregullsi. Të gjitha provat duket se mbështesnin bindjen e tij dhe nuk kishte ndonjë shenjë të ndonjë kërcënimi të sigurisë kombëtare që mund të arsyetonte



Të gjitha provat duket se mbështesnin bindjen e tij dhe nuk kishte ndonjë shenjë të ndonjë kërcënimi të sigurisë kombëtare që mund të arsyetonte përgjimin e bisedave telefonike dhe asnjë autorizim për përgjim nuk ishte lëshuar nga ndonjë prokuror publik.



4. Sinjalizimi

përgjimin e bisedave telefonike dhe asnjë autorizim për përgjim nuk ishte lëshuar nga ndonjë prokuror publik. Për më tepër, gjykatat kishin refuzuar të shqyrtonin meritat e autorizimit të lëshuar nga shërbimi i inteligjencës [listën e shënuar me laps] për përgjimin e bisedave telefonike. Prandaj, gjykatat vendore nuk janë munduar të shqyrtojnë çdo aspekt të këtij rasti, por thjesht kishin pranuar ekzistimin e autorizimeve.

Në mungesë të autorizimeve të cilat qeveria nuk i paraqiti fare, Gjykata i besoi kopjes së dokumenteve të ofruara nga parashtruesi të cilat treguan që shërbimi i inteligjencës nuk kishte dhënë arsye në kërkesën për autorizim të përgjimeve dhe prokurori publik nuk kishte ofruar arsyetim për lëshimin e autorizimit. Sa i përket dëmit ndaj institucionit, interesi i përgjithshëm në aktivitetet e paligjshme të shërbimit të inteligjencës ishte aq i rëndësishëm në një shoqëri demokratike sa tejkalonte interesin e ruajtjes së besimit të publikut në atë institucion. Po ashtu, nuk kishte arsye të besohej që parashtruesi ishte i shtyrë nga motive tjera përveç bërjes publike të shkeljeve ligjore. Kjo mbështetej veçanërisht me faktin që ai nuk kishte zgjedhur të shkonte direkt te mediat që të arrinte te një audiencë e gjerë, por fillimisht kontaktoi deputetin parlamentar. Rrjedhimisht, ndëryrja në të drejtën e parashtruesit për liri të shprehjes, sidomos në të drejtën e tij për të dhënë informacione nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 për parashtruesin e parë dhe shkelje e nenit të 8 për parashtruesin e dytë dhe parashtruesen e tretë (në mënyrë unanime).

4.6 Matúz kundër Hungarisë

Kërkesa nr. 73571/10, 21 janar 2015, Dhoma e Seksionit të Dytë

Parashtruesi i kërkesës, Gábor Matúz, i lindur më 1963 është shtetas hungarez dhe banues në Balassagyarmat (Hungari). Më 2011 ai ishte punësuar për kohë të pacaktuar në televizionin shtetëror Magyar Televízió Zrt (MTZ). Në atë kohë ai ishte edhe kryesues i Sindikatës së Shërbimit për Transmetuesin Publik që funksiononte në kuadër të këtij televizioni. Gazetari ishte redaktor dhe moderator i një emisioni kulturor që përfshinte intervista me figura të ndryshme nga kultura.

Kontrata e punës e obligonte atë të ruante konfidencialitetin profesional. Pas ardhjes së drejtorit të ri të programit, parashtruesi kishte kontaktuar me shkrim presidentin dhe bordin e televizionit për t'u ankuar për censurë, por nuk kishte marrë ndonjë përgjigje. Disa ditë më pas ishte publikuar një artikull që përbante letrën e parashtruesit dhe një deklaratë të Sindikatës së Gazetarëve Hungarezë që kërkonte ndaljen e censurës në televizionin



shtetëror. Më 2004 parashtruesi botoi librin “Antifashistët dhe Hungarista – Sekrete nga Televizioni Hungarez” që përmbante fragmente nga intervista të bëra gjatë vitit 2003, por të cilat nuk ishin transmetuar, bazuar në instruksionet e drejtorit të ri. Libri përmbante edhe letra të brendshme të shkëmbyera në mes të parashtruesit të kërkesës dhe drejtorit.

Si pasojë, gazetari u largua nga puna. Arsyetimi i kompanisë për të larguar gazetarin nga puna ishte se duke publikuar librin ai kishte shkelur nenin që e obligonte për konfidencialitet profesional, sipas të cilit ai nuk mund të publikonte informata që i kishte marrë sa ishte duke punuar që mund ta paragjykonin punëdhënësin e tij. Të gjitha ankesat e parashtruesit kundër largimit nga puna ishin të pasukseshme dhe për këtë arsye ai iu drejtua GjEDNj-së nën pretendimin se largimi nga vendi i punës për shkak të botimit të librit përbënte shkelje të nenit 10 të Konventës.

Sipas Gjykatës, largimi i parashtruesit nga puna përbënte ndërhyrje në të drejtën e tij për liri të shprehjes pasi që vendimi për largimin e tij u mor kur ai publikoi librin. Libri kishte të bënte me çështje me interes publik dhe asnjë palë e tretë nuk ishte ankuar kundër tij. Sipas GjEDNj-së, nëse merret parasysh roli që gazetarët luajnë në një shoqëri demokratike dhe përgjegjësitë e tyre që të kontribuojnë dhe të inkurajojnë debatin publik, kufizimet rreth konfidencialitetit dhe obligimi për diskrecion nuk mund të zbatohen njëjtë ndaj tyre si ndaj të gjithë punëtorëve tjerë, pasi që është në natyrën e tyre të japin informata. Për më tepër, në rastin konkret obligimi i tij për besnikëri dhe përmbajtje duhet të vlerësohet në krahasim me natyrën publike të televizionit shtetëror. Kësisoj, gjatë vlerësimit të veprimeve të parashtruesit, autoritetet vendore duhej t'i kushtonin rëndësi të veçantë interesit publik të ndërlidhur me të.

Autenticiteti i dokumenteve të publikuara nga parashtruesi nuk ishte vënë asnjëherë në pyetje, disa nga deklaratat e tij ishin gjykime të vlerës [opinione], vërtetësia e së cilave nuk kërkonte fakte. Edhe pse publikimi i dokumenteve në librin e parashtruesit përbënte shkelje të konfidencialitetit, përmbajtja e tyre veçse ishte bërë e qasshme për publikun përmes artikullit të botuar më herët online. Lidhur me motivet e parashtruesit, mirëbesimi i tij nuk ishte vënë asnjëherë në pyetje gjatë proceseve gjyqësore vendore. Libri ishte publikuar vetëm pasi parashtruesi i kërkesës ishte munduar të adresonte censurën tek punëdhënësi i tij.

Sanksioni i imponuar – ndërprerja e marrëdhënies së punës - ishte sanksioni më i rëndë. Gjykatat vendore kishin vendosur kundër parashtruesit duke u bazuar vetëm në arsyetimin se publikimi i librit shkelte obligimet kontraktuale, pa e trajtuar argumentin e tij që ai po ushtronte të drejtën e lirisë së shprehjes dhe interesin publik të përfshirë. Rrjedhimisht, ndërhyrja në të drejtën e lirisë së shprehjes së parashtruesit nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)



Nëse merret parasysh roli që gazetarët luajnë në një shoqëri demokratike dhe përgjegjësitë e tyre që të kontribuojnë dhe të inkurajojnë debatin publik, kufizimet rreth konfidencialitetit dhe obligimi për diskrecion nuk mund të zbatohen njëjtë ndaj tyre si ndaj të gjithë punëtorëve tjerë, pasi që është në natyrën e tyre të japin informata.



4.7 Görmüş dhe të tjerët kundër Turqisë

Kërkesa nr. 49085/07, 19 prill 2016, Dhoma e Seksionit të Dytë

Parashtruesit e kërkesës, Ahmet Alper Görmüş, Mehmet Ferda Balancar, Ahmet Haşim Akman, Ahmet Şık, Nevzat Çiçek, dhe Banu Uzpeder, janë shtetas turq të cilët jetojnë në Antalia dhe Stamboll. Në atë kohë ata punonin si drejtorë, kryeredaktorë dhe gazetarë hulumtues në gazetën javore Nokta.



Të drejtat dhe përgjegjësitë e gazetarëve përfshijë obligimin që të mos botojnë informacione të ofruara nga sinjalizuesit deri sa sinjalizuesit të kenë përdorur procedurat e ofruara administrative për të informuar mbikëqyrësit e tyre.

Në prill 2007 Nokta publikoi një artikull të bazuar në dokumente të klasifikuara si “konfidenciale” nga shefi i kabinetit të forcave të armatosura. Artikulli trajtonte klasifikimin nga ushtria të kompanive botuese dhe gazetarëve si “të favorshëm” ose “armiçësorë”, ashtu që disa gazetarë specifikë të mund të përjashtoheshin nga aktivitetet e organizuara nga ushtria. Pas kallëzimit penal të ushtruar nga shefi i kabinetit të forcave të armatosura kundër mediumit, gjykata ushtarake urdhëroi kontrollimin e zyrave të gazetës, duke kërkuar kopje elektronike dhe fizike të të gjitha dosjeve të ruajtura në kompjuterë privatë dhe profesionale, në arkiv dhe në vende të tjera ku ruheshin materialet e gazetarëve. Në fillim të kontrollimit, Görmüş dorëzoi dokumentet e kërkuara nga prokurori ushtarak te zyrtarët policorë. Në ndërkohë, avokatët që përfaqësonin gazetën Nokta dhe Görmüş ishin ankuar kundër urdhrit për kontrollim nën arsyetimin se përbënte shkelje të së drejtës për të mbrojtur burimet e gazetarëve. Gjykata ushtarake hodhi poshtë ankesën duke u justifikuar se kontrollimi dhe sekuestrimi ishtë bërë për të hedhur dritë në rrethanat rreth rrjedhjes së dokumentit të klasifikuar si “sekret” dhe jo për të identifikuar përgjegjësit e rrjedhjes. Kjo gjykatë po ashtu kishte theksuar se përdorimi apo publikimi i informatave që ishte e ndaluar të botoheshin ishte vepër penale dhe se gazetarët nuk përjashtoheshin nga kjo përgjegjësi.

Parashtruesit paraqitën ankesë në GjEDNj nën pretendimin se kontrollimi dhe sekuestrimi përbënte shkelje të së drejtës për të mbrojtur burimet, të garantuar me nenin 10 të Konventës. Fillimisht Gjykata bëri vlerësimin e kontributit të artikullit të kontestuar në debat publik. Ajo vërejti se dokumentet e zbuluara përmbanin vlerësime të bëra nga forcat e armatosura me qëllim që t’u mundësonin atyre përzgjedhjen e gazetarëve të cilët do të ftoheshin për të mbuluar ngjarjet e ushtrisë. Gjykata tutje theksoi se shkrimet e kontestuara përmbanin çështje të përfshirjes së ushtrisë në politikë që ishin diskutur në masë të madhe në media dhe të cilat kishin ndarë opinionin publik. Organizatat



kryesore për media kishin protestuar kundër praktikës selektive të ushtrisë, të cilën e kishin cilësuar si arbitrare dhe të dëmshme për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, pasi që gazetarët ishin klasifikuar varësisht nga raportimet me qëllim të përjashtimit të disave prej tyre. Në këtë aspekt, gjykata vlerësoi se qëndrimet e mbrojtura në artikull dhe dokumentet e zbuluara kontribuonin në debat publik.

Pastaj Gjykata vlerësoi çështjen e mbrojtjes së burimeve të gazetarëve ku vërejti se për të identifikuar punëtorët nga të cilët rrodhën informatat konfidenciale, autoritetet gjyqësore kishin kontrolluar vendin e punës së tre gazetarëve pa i paralajmëruar fare dhe kishin sekuestruar të gjitha dokumentet e tyre. Gjykata vlerësoi se ky veprim ishte shumë më serioz sesa një urdhër që urdhëron vetëm zbulimin e identitetit të një burimi. Edhe pse drejtori i kishte dorëzuar dokumentet e kërkuara te hetuesit, këta të fundit prapëseprapë kishin transferuar të dhëna nga 46 kompjuterë. Rrjedhimisht, intervenimi i autoriteteve gjyqësore kishte tejkaluar kërkesën fillestare të prokurorit të ushtrisë, e që ishte dorëzimi i dosjes ashtu siç kishte rrjedhur nga sinjalizuesi. Një intervenim i tillë dekurajon burimet e mundshme që të ndihmojnë shtypin në informimin e publikut për çështje me rëndësi.

Sa i përket mbrojtjes së sinjalizuesve të cilët ishin zyrtarë shtetërorë, Gjykata vërejti që hetimi synonte identifikimin dhe arrestimin e përgjegjësve të rrjedhjes së informacioneve. Në këtë aspekt, Gjykata theksoi se të drejtat dhe përgjegjësitë e gazetarëve përfshijë obligimin që të mos botojnë informacione të ofruara nga sinjalizuesit deri sa sinjalizuesit të kenë përdorur procedurat e ofruara administrative për të informuar mbikëqyrësit e tyre. Në rastin konkret, legjislacioni turk nuk parashihte një procedurë të tillë. Prandaj gazetarët nuk mund të kritikoheshin për publikimin e materialit të kontestuar pa i pritur burimet që të ngrenë shqetësimet tyre përmes zinxhirit komandues.

Lidhur me konfidencialitetin e çështjeve ushtarake, Gjykata pranoi faktin se në parim arsyetohet natyra konfidenciale e funksionimit të ushtrisë, por ky konfidencialitet nuk duhet të mbrohet me çdo kusht. Detyra e mediave që të ofrojnë informacione përfshin edhe informacionet që ndërlidhen me ushtrinë dhe ndalimi i debatit publik ku përfshihet ushtria është i paparanueshëm. Për më tepër, Gjykata vërejti se arsyet për të cilat ishin klasifikuar dokumentet në fjalë nuk ishin të pranueshme, pasi që qeveria nuk kishte dëshmuar që zbulimi i atyre dokumenteve mund të ketë pasur efekt dëmtues. Gjykata konsideroi që artikujt e kontestuar kanë qenë shumë të rëndësishëm në debatin rreth diskriminimit të mediave nga organet shtetërore, sidomos për shkak se stili i përdorur në artikull nuk kishte rrezikuar interesat shtetëror. Interesi publik për zbulimin e informacioneve që tregojnë praktikën e përdorura nga forcat e armatosura ishte aq i rëndësishëm në një shoqëri demokratike sa që tejkalonte interesin e ruajtjes së besimit në atë institucion.

Gjykata po ashtu gjeti që gazetarët kishin punuar në përputhje me kodin e etikës profesionale, nuk ishte evidentuar ndonjë shkelje dhe se gazetarët në fjalë kishin për qëllim



Detyra e mediave që të ofrojnë informacione përfshin edhe informacionet që ndërlidhen me ushtrinë dhe ndalimi i debatit publik ku përfshihet ushtria është i paparanueshëm.



4. Sinjalizimi

vetëm informimin e publikut për një temë me interes të përgjithshëm. Në fund, duke ekzaminuar proporcionalitetin e ndërhyrjes, Gjykata konsideroi se kontrollimi i zyrave të gazetës, transferimi i të gjitha dokumenteve që gjendeshin në kompjuterë në një disk të jashtëm dhe ruajtja e tyre në zyrën e prokurorit ishte më e dëmshme sesa t'u kërkohet atyre që vetë të zbulonin burimin. Ky intervenim nuk ishte proporcional dhe ka mundur të ketë pasoja jo vetëm në lidhjet e gazetarëve me burimet e tyre, por edhe të ketë efekt frenues serioz në sinjalizuesit që janë zyrtarë shtetërorë. Për këto arsye, gjykata gjeti që kishte shkelje të nenit 10 të Konventës, pasi që ndërhyrja në të drejtën e gazetarëve për liri të shprehjes, sidomos në të drejtën për të dhënë dhe marrë informata, nuk ishte nevojë me urgjencë shoqërore, nuk ishte proporcionale me qëllimin e ndjekur dhe rrjedhimisht nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Vendimi: Shkelje e nenit 10 të Konventës (në mënyrë unanime)





Seancë gjyqësore e mbajtur nga Dhoma e Madhe (2016)
© Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut



Sesioni i 122-të i Këshillit të Ministrave (2012)
Foto: Ellen Wuibaux, © Këshilli i Europës

5. Burimet





5. Burimet

Përgatitja e rasteve për këtë përmbledhje është bërë duke u bazuar në aktgjykimet, shënimet informative të jurisprudencës dhe komunikatat për shtyp të GjEDNj-së. Materialet e gjykatës mund të gjenden në databazën e GjEDNj-së të quajtur Hudoc që ndodhet në këtë link: <http://hudoc.echr.coe.int/>. Burime tjera që ofrojnë informacione dhe interpretime të jurisprudencës së GjEDNj-së në të drejtën e lirisë së shprehjes, mund të gjenden në platformat e mëposhtme:

IRIS, European Audiovisual Observatory:

[http://www.obs.coe.int/documents/205595/2667238/IRIS+Themes+III+\(final+9+December+2013\).pdf/2e748bd5-7108-4ea7-baa6-59332f885418](http://www.obs.coe.int/documents/205595/2667238/IRIS+Themes+III+(final+9+December+2013).pdf/2e748bd5-7108-4ea7-baa6-59332f885418)

Global Freedom of Expression, Columbia University:

<https://globalfreedomofexpression.columbia.edu/>

Strasbourg Observers, Ghent University:

<http://strasbourgobservers.com/>

Lista e rasteve:

E drejta e qasjes në dokumente publike

GjEDNj, Khurshid Mustafa dhe Tarzibachi kundër Suedisë, kërkesa nr. 23883/06, 16 mars 2009, Dhoma e Seksionit të Tretë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-90234"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë, kërkesa nr. 37374/05, 14 korrik 2009, Dhoma e Seksionit të Dytë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-92171"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Kenedi kundër Hungarisë, kërkesa nr. 31475/05, 26 gusht 2009, Dhoma e Seksionit të Dytë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-92663"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Gillberg kundër Suedisë, kërkesa nr. 41723/06, 3 prill 2012, Dhoma e Madhe, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-110144"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Youth Initiative for Human Rights kundër Serbisë, kërkesa nr. 48135/06, 25 shtator 2013, Dhoma e Seksionit të Dytë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"fulltext":\["youth"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-120955"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)



GjEDNj, Österreichische Vereinigung zur Erhaltung, Sträkung und Schaffung Eines
Eirtschaftlich Gesunden Land- und ForstEirtschaftlichen Grundbesitzes kundër Aus-
trisë, kërkesa nr. 39534/07, 28 shkurt 2014, Dhoma e Seksionit të Parë, mund të gjendet
në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-139084"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Rosiianu kundër Rumanisë, kërkesa nr. 27329/06, 24 shtator 2014,
Dhoma e Seksionit të Tretë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-144999"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Guseva kundër Bulgarisë, kërkesa nr. 6987/07, 6 korrik 2015, Dhoma e Seksionit
të Katërt, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-152416"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

E drejta mbrojtjes së burimeve të gazetarëve

GjEDNj, Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 17488/90, 27
mars 1996, Dhoma e Madhe, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-57974"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Roemen dhe Schmit kundër Luksemburg, kërkesa nr. 51772/99, 25 maj 2003,
Dhoma e Seksionit të Katërt, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"languageisocode":\["ENG"\],"appno":\["51772/99"\],"documentcollectionid2":\["CHAMBER"\],"itemid":\["001-60958"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Ernst dhe të tjerët kundër Belgjikës, kërkesa nr. 33400/96, 15 tetor 2003,
Dhoma e Seksionit të Dytë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-65779"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Voskuil kundër Hollandës, kërkesa nr. 64752/01, 22 shkurt 2008, Dhoma
e Seksionit të Tretë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-83413"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Tillack kundër Belgjikës, kërkesa nr. 20477/05, 27 shkurt 2008, Dhoma e Seksionit
të Dytë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-83527"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Financial Times dhe të tjerët kundër Britanisë së Bashkuar, kërkesa nr. 821/03,
15 mars 2010, Dhoma e Seksionit të Katërt, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-96157"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Sanoma Uitgevers kundër Hollandës, kërkesa nr. 38224/03, 14 shtator
2010, Dhoma e Madhe, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-100448"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)



5. Burimet

GjEDNj, Ressiott dhe të tjerët kundër Francës, kërkesa nr. 15054/07 dhe 15066/07, 28 shtator 2012, Dhoma e Seksionit të Pestë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-111670"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Martin dhe të tjerët kundër Francës, kërkesa nr. 30002/08, 12 korrik 2012, Dhoma e Seksionit të Pestë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-110306"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Telegraaf Media Nederland Landelijke Media B.V. dhe të tjerët kundër Hollandës, kërkesa nr. 39315/06, 22 shkurt 2013, Dhoma e Seksionit të Tretë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-114439"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Saint-Paul Luxembourg kundër Luksemburgut, kërkesa nr. 26419/10, 18 korrik 2013, Dhoma e Seksionit të Pestë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-119055"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Nagla kundër Letonisë, kërkesa nr. 73469/10, 16 tetor 2013, Dhoma e Seksionit të Katërt, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-122374"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

Sinjalizimi

GjEDNj, Guja kundër Moldavisë, kërkesa nr. 14277/04, 12 shkurt 2008, Dhoma e Madhe, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-85016"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Marchenko kundër Ukrainës, kërkesa nr. 4063/04, 19 maj 2009, Dhoma e Seksionit të Pestë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-91415"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Kudeshkina kundër Ruisë, kërkesa nr. 29492/05, 26 shtator 2009, Dhoma e Seksionit të Parë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-91501"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Heinisch kundër Gjermanisë, kërkesa nr. 28274/08, 21 tetor 2011, Dhoma e Seksionit të Pestë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-105777"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)



GjEDNj, Bucur and Toma kundër Rumanisë, kërkesa nr. 40238/02, 8 prill 2013, Dhoma e Seksionit të Tretë, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-115844"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNj, Matúz kundër Hungarisë, kërkesa nr. 73571/10, 21 janar 2015, Dhoma e Seksionit të Dytë, mund të gjendet në [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-147276"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

GjEDNJ, Görmüş dhe të tjerët kundër Turqisë, kërkesa nr. 49085/07, 19 prill 2016, Dhoma e Seksionit të Dytë, mund të gjendet: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-160244"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)



Seancë gjyqësore e mbajtur nga Dhoma e Madhe (2016)
© Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë.

Implementuar nga **Thomson Foundation** 